13167

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr.VENDIMI 13167

DATE: ____________

## V E N D I M

## PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me daten 22-12-95 une gjyqtarja M. Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Dhimitri Bezaitis dhe FFedhon Ioanidhis,me objekt regjistrimin si person juridik te shoqerise me per gjegjesi te kufizuar "DURRES sh.p.k.""me ortake te dy kerkuesit dhe

## K O N S T A T O V A

Kerkuesit Dhimitri Bezaitis dhe Fedhon Ioanidhis ne baze te ak tit te themelimit date 15 Dhjetor 1995 dhe te statutit te miratuar prej tyre,dokumenta keto te legalizuara ne Noteri,kane themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DURRES sh.p.k." me qender ne Durres,me kapi tal themeltar 100.000 leke te formuar nga te dy ortaket me kontribut te barabarte,me afat veprimtarie per 15 vjete dhe me objekt: Prodhimin dhe tregetimin e bojrave te ndryshme,si dhe te materialeve te tjera te nder timit.Prodhimin ne forme import eksporti te parafabrikateve te ndryshme dhe te pajisjeve per sektorin e ndertimit te banesave,objekteve te kara kterit industrial e shoqeror.Ushtrimin e tregetise ne forme import eks porti me shumice e me pakice te mallrave nga te gjitha llojet pa kufi- zim;si te mallrave industriale,makineri e pajisje,pjese kembimi per industrine dhe automjetet,aparatura elektroshtepijake,artikuj ushqimore te cdo lloji,prodhime bujqesore e blegtorale,prodhime farmaceutike per njerezit,kafshet dhe bimet,si dhe te lidh marreveshje perfaqesimi per marrjen e kredive nga bankat e Komunitetit Evropian.

Te gjitha dokumentat per krijimin e kesaj shoqerie jane te rre- gullta dhe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi,prandaj ka vend te prano- het kerkesa e tyre per regjistrimin e kesaj shoqerie.

PER KETO ARESYE

Gjykata ne baze te nenit 37 e vijues te Ligjit Nr.7667 date 28.I.1993,

## V E N D O S I

Te regjistroje si pe rson juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DURRES sh.p.k." me qender ne Durres lagja Nr.14 ne teritorin Uzines se Elektrodave,me ortak DHIMITRI BEZAITIS dhe FEDHON IOANIDHIS me kapital 100.000 leke te investuar ne menyre te barabarte nga te dy ortaket,me afat veprimtarie prej 15 vjetesh dhe me objekt:Prodhimin dhe tregetimin e bojrave te ndryshme si dhe te materialeve te tjera te nder- timit.Prodhimin dhe tregetimin ne forme import eksporti te parafabrika- teve te ndryshme dhe te pajisjeve per sektorin e ndertimit te banesave objekteve te karakterit industrial dhe shoqeror.Ushtrimin e tregetise ne forme import eksporti,me shumice dhe me pakice te mallrave nga te gjitha llojet pak kufizim,si te mallrave industriale,makineri e pajisje pjese kembimi per industrine e automjetet,aparatura elektroshtepijake,

artikuj usnqimore te çdo lloji,prodhime bujqesore e blegtorale,prodhime farmaceutike per njerezit,kafshet dhe bimet,si dhe te lidh marreveshje perfaqesimi per marrjen e kredive nga bankat e Komunitetit Evropian.

Administrator i shoqeris c"DURRES sh.p.k." eshte Z.DHIMITRI BEZAITIS.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit.

G J Y Q T A R J A

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 13167/1

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Une,gjyqtare e vetme e Gjykates se rrethit Tirane M. Dedi sot me daten 14.06.1996,mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur prej,

Kerkuesve: Dhimitri Bezaitis dhe Fedhon Ioanidhis,ortake themelues te shoqerise " DURRES "SH.P.K.,lidhur ne depozitimin prane Gjykates sone te vendimit te Asamblese se Shoqerise dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr.1 date 14.03.1996,asamblea e shoqerise " DURRES "SH.P.K.ka vendosur te largoje nga shoqeria ortakun Fedhon Ioanidhi,te pranoje ortak te ri ne shoqeri te quajturin Sotirios Sotiropullos dhe te behet transferimi i kapitalit te shoqerise ne masen 50% nga ortaku Fedhon Ioanidhi qe eshte larguar tek ortaku Sotirios Sotiropullos qe eshte pranuar ortak i ri ne shoqeri,duke bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit sipas nenit 33/e te ligjit 7667 date 28.01.1993.Kerkesa e paraqitur nga kerkuesit qmoj se eshte e drejte dhe e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 33/e te ligjit 7667 date 28.01.1993,

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses dhe depozitimin ne Gjykaten e rrethit Tirane te vendimit Nr.1 date 14.03.1996,te Asamblese se Shoqerise " DURRES "SH.P.K.,duke u bere shenimi ne kollonen Nr.2/5 dhe 4 duke u ndare regjistrimet nga njeri me vize te kuqe.

GJYQTARE

Majlinda Dedi

[illegible] E SHQIPERISE
D[illegible] E
Nr. [illegible] 13164/2

# V [illegible] D I [illegible]

## [illegible] EM

Sot më datën 7.08.1996 [illegible] Tiranë, mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Sotirios Sotiropullos për depozitimin e dokumentacionit për largimin e ortakut [illegible] Bezaitis nga shoqeria "DURRES"-SHPK:

V [illegible] J:

Se zoti Sotirios Sotiropullos, [illegible] administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "[illegible]"-SHPK [illegible] me V[illegible] Gjykate nr. 13167 date 22.12.1995.

Me Vendim [illegible] të [illegible] Vendosur të bëhet largimi i ortakut Dhimitrios Bezaitis [illegible] "DURRES"-SHPK, ti shiten kuotat e kapitalit te or[illegible] larg[illegible], [illegible] Vetem të shoqërise Sotirios Sotiropullos, i c[illegible] z[illegible] [illegible] 100% të kuotave të kapitalit te shoqerisë.

[illegible] regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit [illegible].

[illegible] e drejte dhe e bazuar në ligj prandaj si e tille d[illegible].

## [illegible]

Në bazë të ligjit [illegible] 4.11.1992

## V [illegible] D O S A

Pra[illegible].

[illegible]itimin pranë regjistrit treg[illegible] Vendimin [illegible] 1 [illegible] ortakëve ku bëhet fjalë për largimin e ortakut [illegible] kapitalit ortakut të vetëm Sotirios Sotiropullos, i cili [illegible] dhe administratori i shoqeri e"Durres"-SHPK.

[illegible] regjistrit tregtar te bej ndryshimet [illegible] nr. 3, 4, 5 [illegible]

Ndarje me vize [illegible] perkatëse.

Kundër ketij vendimi lejohet të bëhet a[illegible] në Gjykatën e [illegible] së [illegible].

Tiranë me 7.08.1996

G J Y Q T A R E

[illegible]

B867/3

23

13167/3 [illegible]

V [illegible]

[illegible] V [illegible]

[illegible] ne daten 23.12.1996, une [illegible] gjykate se [illegible] Tirane [illegible] ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga [illegible] Sotirios Sotiropullos, [illegible] i shoqerise [illegible] ( [illegible] ); [illegible] per disa ndryshime ne Statut dhe ne aktin e [illegible] te shoqerise [illegible] [illegible] ;

V [illegible] :

[illegible] baze te vendimit nr.13167/1 date 07.0[illegible] shoqeria [illegible] eshte kthyer ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, [illegible] i vetem, [illegible] i tille mbetej z. Sotirios Sotiropullos.

[illegible] vendimin e [illegible] date 23.1[illegible] eshte njohur [illegible] kuotave te shoqerise [illegible] ; kuota te cilat i [illegible] blere [illegible] baze te kontrates noteriale nr.714[illegible]/199[illegible] date 23.10.1996 ne shumen 1.000.000 ([illegible]milion) lek, [illegible] Sotirios [illegible] i mbetet 60 ([illegible]) [illegible] kapitalit themeltar te shoqerise "Durres [illegible]".

[illegible] ndryshime ne aktin e [illegible] statut ne [illegible] kapitalin [illegible] kuotave te secilit prej tyre duhet te pasqyrohen ne [illegible] regjistar.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj [illegible] si e tille duhet pranuar.

[illegible] :

[illegible] baze te ligjit 7632 date 0[illegible].11.1992 ;

V [illegible] S [illegible] :

[illegible] e kerkeses.

Depozitim [illegible] vendimit nr.7141/[illegible] date [illegible] te [illegible] te [illegible] , ku behet fjale per [illegible] [illegible]

[illegible] otirion oiliromu[illegible]os. [illegible] [illegible] te [illegible]

[illegible] [illegible]

[illegible]

[illegible] [illegible]

[illegible] nr. 4 dhe 5 me nr. rendor 3.

[illegible]

[illegible]

[illegible]

nge ortaku i Vetem Sotirios Sotiropullos. Sejcili nga ortaket ka te drejte te kryeje veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise "Durres " SH.P.K. dhe do te jene administratore te shoqerise.

Urdherimin e Zyres se Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkates ne kolonen nr.**4 dhe 5 me nr. rendor 3.**

Nxarjen me viza te kuqe te ndryshimeve perkatese.

[illegible].

G J Y Q T A R E

FLORINA TEGU

REPUBLIKA E SHQIPERISE

3

GJYKATA RRETHIT TIRANE

Nr. 13167/4 Vendimi.

GJY[illegible] TIRANE

V E N D I M

I GJ[illegible]

Sot me date 18.11.1997 ne qytetin e Tiranes, une [illegible]la Capo, Gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesve Kujtim [illegible]eqja dhe Sotirios [illegible] per depozitimin e dokumentacionit per largimin e ortakut Sotirios Sotiropullos nga Shoqeria " DURRESI" SH.P.K.

[illegible] :

Me vendimin nr.13167 [illegible] te 22.12.1995 eshte [illegible] shoqeria "[illegible]" [illegible] si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar prane [illegible] Tregtar [illegible] me kontraten e shitjes nr.7140 rep. dhe 195[illegible] kol. date 23.10.[illegible], kerkuesit Kujtim Beqja dhe Sotirios Sotiropullos [illegible] te shoqerise, ku Kujtim Beqja [illegible] 40 % te kuotave, ndersa Sotirios Sotiropullos [illegible] te kuotave ne kete shoqeri.

Me kontraten noteriale nr.4289 rep. dhe 1352 kol date 20.08.1997 eshte bere shitja e kuotave [illegible] te mesiperm , ku Kujtim Beqja ka blere 60 % te kuotave te ortakut Sotirios Sotiropullos ne shumen 1.200.000 lek dhe Kujtim Beqja mbeten Ortak i vetem i Shoqerise "Durresi" SH.P.K. dhe ngelet [illegible] administrator i saj.

Keto ndryshime te reflektohen ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatese rrethit Tirane.

Kerkese eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, prandaj si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Me baze te nenit 33 te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 ;

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane Regjistrit tregtar te vendimit nr.4289 rep.1352 kol dato

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA RRETHIT TIRANE

NR. 13167/2 Vendimi.

3

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 18.11.1997 ne qytetin e Tiranes, une Anila Capo, Gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesve Kujtim Beqja dhe Sotirios Sotiropullos per depozitimin e dokumentacionit per largimin e Ortakut Sotirios Sotiropullos nga Shoqeria " DURRESI" SH.P.K.

V E R E J :

Me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 eshte rregjistruar shoqeria "DURRESI" SH.P.K. si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar prane Rregjistrit Tregtar dhe pas disa ndryshimeve te mevonshme me kontraten e shitjes nr.7140 rep.dhe 1954 Kol. date 23.10.1996, kerkuesit Kujtim Beqja dhe Sotirios Sotiropullos jane bere bashkeortake te shoqerise, ku Kujtim Beqja kishte 40 % te kuotave, nderse Sotirios Sotiropullos kishte 60 % te kuotave ne kete shoqeri.

Me kontraten noteriale nr.4289 rep. dhe 1392 Kol date 20.08.1997 eshte bere shitja e kuotave midis ortakeve te mesiperm , ku Kujtim Beqja ka blere 60 % te kuotave te ortakut Sotirios Sotiropullos ne shumen 1.200.000 lek dhe Kujtim Beqja mbeten Ortak i vetem i shoqerise "Durresi" SH.P.K. dhe njekohesisht administrator i saj.

keto ndryshime te reflektohen ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykatesse rrethit Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, prandaj si e till duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te nenit 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 ;

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

20.08.1997 ku behet fjale per shitjen ækuotave te ortakut Sotirios Sotirop llos Ortakut Kujtim Beqja , i cili mbetet Ortak i Vetem dhe administrator i Shoqerise "DURRESI" Sh.P.K.

Urdherimin e Zyres Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne fleten perkatese me nr.2 dhe kolonen nr.3,4,5.

Rregjistrimet perkatese te ndahen me vije te kuqe nga njera tjetra.

G J Y Q T A R E

[illegible] CAPO

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA RRETHIT TIRANE

Nr. 13167/5 Vendimi.

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 15.04.1998 ne qytetin e Tiranes, une gjyqtare Gjykates rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Kujtim Beqja ; ortak i Vetem dhe administrator i shoqerise " DURRESI" SH.P.K. per depozitimin e dokumentacionit per ndryshimin e emrit te Shoqerise " DURRESI" SH.P.K. dhe ;

## K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 eshte rregjistruar shoqeria "Durresi" Sh.P.K.; si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar ne Rregjistrin Tregtar. Kjo shoqeri tashme sipas vendimit nr. 13167/2 date 18.11.1997 eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,Ortak i Vetem; me administrator Kujtim Beqja, i cili eshte dhe Ortaku i saj.

Duke qene se me vendimin nr.4 date 10.04.1998 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ndryshimi i emrit te shoqerise nga " DURRESI" SH.P.K. ne " DORIAN " SH.P.K.; kerkese kjo e drejte dhe e bazuar ne ligj, prandaj si e tille duhet pranuar.

Ky ndryshim i emrit te shoqerise duhet te pasqyrohet ne Rregjistrin Tregtar.

## PER KETO ARESYE

Per keto aresye ne baze te neneve 23 e 24 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 " Per rregjistrin tregtar";

## V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e vendimit nr.04 date 10.04.1998 te Ortakut te Vetem,Kujtim Beqja,ne Rregjistrin Tregtar per ndryshimin e emrit te shoqerise ne "DORIAN" SH.P.K.

%

Urdherimin e Zyres Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimin perkates te emrit te shoqerise ne fleten perkatese ne kollonen nr.2 (a).

Rregjistrimi perkates te ndahet me vije te kuqe.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. VENDIMIT 13167/6

5725

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM .-

Sot, me daten 25-09-98 une Gjyqtarja e Gjykates se rrethit te Tiranes, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Kujtim Beqja, ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "DORIAN"sh.p.k. per depozitimin e dokumentacionit per shtim ortakesh dhe transferim kuotash te kesaj shoqerie dhe

## K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 eshte regjistruar shoqeria "DURRESI"sh.p.k. si shoqeri tregetare me pergjegjesite kufizuar. Me vendimin nr.13167/1 date 18.11.1997 ka kaluar si ortak i vetem dhe administrator Kujtim Beqja. Me vendimin nr.13167/3 date 15.04.1998 te Gjykates se rrethit Tirane eshte ndryshuar emri i kesaj shoqerie ne "DORIAN"sh.p.k.

Duke qene se me vendimin nr.5 date 23.09.1998 te ortakut te vetem eshte vendosur shtimi i ortakeve dhe transferimi ne favor te tyre i pjeseve te kapitalit, kjo kerkese eshte gjetur e drejte dhe e bazuar ne ligj, prandaj duhet pranuar.

Ky ndryshim duhet te pasqyrohet edhe ne Regjistrin Tregetar.

## PER KETE ARESYE :

Ne baze te neneve 21 te Ligjit nr.7632 date 4.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodir Tregetar", 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar".

## V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin eyendimit nr.5 date 23.09.1998 te ortakut te vetem Kujtim Beqja per transferimin e 23% te kuotave tek Dhimitri Luleme, 23% te kuotave te Milto Hodaj, 23% te kuotave te Artan Beqja dhe 5% te kuotave tek Kristo Spilotopullos, te cilet hyjne si ortake ne kete shoqeri me perqindjet e mesiperme, ndersa Kujtim Beqja mbetet me 26 % te kuotave.

Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregetar te beje ndrshimet perkatese ne Skeden perkatese te Regjistritte kesaj shoqerie ne kollonen 4 duke u ndare regjistrimi ne vije te kuqe.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1005 NR.KOL. 304

**PROKURE**

Ne Durres, sot me daten 2.08.1999(dy gusht nentedhjete-nente) ne Dhomen e Noterove Durres, para meje noteres SHPRESA SKRAME u paraqit personalisht: ——

POROSITESI: CHRISTOS SPILIOTOPOULOS, i biri Nikolaos, lindur me 09.05.1940, ne Agioi Anargyroi, Attikis, Greqi, shtetas grek, me zotesi te plote per te vepruar, identiteti sipas pasaportes numer 767761 leshuar nga autoritetet e Prefektures se Athines, i shoqeruar nga: ——

PERKHTYESI: MILTO HODAJ, i biri i Avniut, lindur me 28.12.1962 ne Mallakaster, banues ne Ballsh, identiteti sipas pasaportes nr.103722 leshuar nga autoritetet shqiptare, i cili mori persiper rolin e intrepretit dhe me kerkoi redaktimin e kesaj prokure: ——

" Emeroj dhe caktoj si perfaqesues timin z. DHIMITRI LULEME, i biri i Shomos, lindur me 1.07.1964 ne Gjirokaster, banues ne Kavaje, identiteti sipas leternjoftimit NF NR.231682, per te me perfaqesuar ne te gjitha procedurat per transferim kuotash te shoqerise DORIAN shpk, e njohur dhe regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 dhe me ndryshimet e mevoneshme. I jap te drejte dhe kompetence qe ne emer, per llogari dhe ne interesin tim, te marre pjese ne hartimin e dokumentacionit perkates, te nderhyje ne redaktimin e permbajtjes se akteve te ndryshme dhe t'i nenshkruaje ato, me qellim qe te gjithe ortaket e kesaj shoqeria, ne te cilet bej pjese edhe une, te kene nje numer te barabarte kuotash.——"

Prokura e mesiperme, ju interpretua nga perkthyesi i shenuar me lart ne pranine time dhe porositesi deklaroi se eshte dakord me permbajtjen e saj, pasi shpreh deshiren dhe vullnetin e tij te lire e te plote, prandaj e nenshkruan para meje. Gjithashtu para meje, noteres nenshkroi edhe perkhtyesi.——

— —

Une, noterja, pasi redaktova sa me siper ne perputhje me nenet 64-78 te K.C. dhe ligjin nr.7829 date 1.06.1994, vertetoj.----

**P O R O S I T E S I**

**SPILIOTOPOULOS Christos**

ΣΠΗΛΙΟΤΟΠΟΥΛΟΣ ΧΡΗΣΤΟΣ

**PERKTHYESI**

**Milto HODAJ**

Milto Hodaj

**NOTERE**

**SHPRESA KRAME**

PULLE TAKSE 100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE SHPRESA KRAME NOTERE DURRES

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. VENDIMIT 13167/ 7
NR.DEPOZITIMIT 7319

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM .-

Sot, me daten 08 - 11-99 une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit te shoqerise DORIAN shpk, Kujtim Beqja dhe

K O N S T A T O V A :

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DORIAN"shpk, me qendei ne Durres, e njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, pas disa ndryshimeve te mevoneshme, aktualisht perbehet nga pese ortake: Kujtim Beqja me 26% te kuotave, Dhimiter Luleme me 23% te kuotave, Milto Hodo me 23% te kuotave, Artan Beqja me 23 % te kuotav dhe Christos Spiliotopoulos me 5% te kuotave, te nje kapitali prej 100.000 leke.

Me vendimin nr.6 date 4.08.1999 te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie, ata kane vendosur qe te gjithe ortaket te zoterojne nje numer te barabarte kuotash secili pra nga 20% secili ose baraz me 20.000 leke. Per kete eshte hartuar para noterit edhe kontr ta perkatese e shitblerjes se kuotave.

Gjithashtu, meqenese me pare kjo shoqeri ka qene me nje ortak te vetem dhe me pas eshte bere me 5 ortake, Asambleja e Ortakeve ka miratuar statutin e ndryshuar qe i pershtatet kushteve te nje shoqerie me shume anetare ortake.

Eshte kerkuar depozitimi i ketyre akteve prane Regjistrit Tregetar.

Ne baze te Ligjit nr.7667 date 28.I.93 çmoj se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te nenit 21 te Ligjit nr.7632 date 4.11.1992 "Per Pjesen e Pergjitheshme te Kodir Tregetar"; neneve 49 e 60 te

Ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per Shoqerite Tregetare" dhe nenit 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.93 "Per Regjistrin Tregetar"

V E N D O S A :

- Pranimin per depozitim te vendimit te Asamblese se ortakeve me ane te te cilit behet shitblerja e kuotave dhe transferimi i kuotave ndermjet ortakeve Kujtim Beqja, Dhimiter Luleme, Milto Hodo, Artan Beqja dhe Christos Spiliotopoulos, duke u bere secili prej tyre me nga 20 % te kuotave.

- Pranimin per depozitim te Statutit (te ndryshuar) te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

- Urdherimin e zyres se Regjistrit Tregetar te beje shenime ne Skeden e regjistrimit te kesaj shoqerie duke u ndare regjistrimi nga shenimet e mepareshme ne vije te kuqe.

GJYQTARE

Marjana [signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR.VENDIMIT 13167/9
NR.DEPOZITIMIT

***V E N D I M***
***I GJYQTARIT TE VETEM***

Sot,me daten 12.11 2004, unë gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kujtim Beqja, qe kerkon te beje ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre ne kapitalin e shoqerise "DORIAN " shpk , si dhe te shtoje kapitalin shoqeror, dhe

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "DORIAN shpk, me qender ne Durrës, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe, aktualisht perbehet nga kater ortake te cilet jane; Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodaj dhe Artan Beqja,qe perbejne Asamblene e Ortakeve dhe qe zoterojne secili prej tyre nga 25% te kuotave. Aktiviteti i kesaj shoqerie nuk ka ndryshuar dhe, kryesisht është ne fushen e prodhimit dhe tregtimit te bojrave, administrator është Kujtim Beqja.

Duke pare ecurine e veprimtarise se shoqerise, Asambleja e Ortakeve ka vendosur te shtoje kapitalin themelor. Per te bere te mundur fillimin e procedurave, eshte menduar te emerohet si eksperte kontabel zj.Nadire Hyseni, e cila eshte pajisur me licence si EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR, me ane te licences te Institutit te Eksperteve. Kjo eshte pasqyruar ne vendimin nr.8 date 16.06.2004 te Asamblese se Ortakeve.

Me vendimin nr.13167/8 date 08.07.2004 te Gjykates se rrethit Tirane, eshte bere miratimi i zj.Nadire Hyseni si eksperte kontabel per vleresimet lidhur me zmadhimin e kapitalit.

Sipas Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar, nenshkruar ma daten 30.09.2004, zmadhimi i kapitalit te shoqerise DORIAN sh.p.k, nga 100.000 leke ne 5.000.000 leke eshte i drejte, i argumentuar dhe real, i mbeshtetur ne aktivitetin e shoqerise dhe ne perdorimin e fondeve rezerve.

Ne baze te Ligjit, kerkesa është e drejte dhe prandaj duhet pranuar.

PER KETE ARESYE,

Bazuar ne nenin 21 te Ligjit nr.7632 date 4.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", ne nenet 45 e 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"dhe ne nenin 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993"Per Regjistrin Tregetar",

## V E N D O S A

Depozitimin e vendimit nr.8 date 16.10.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DORIAN" sh.p.k, qe ka vendosur te zmadhoje kapitalin shoqeror nga 100.000 leke ne 5.000.000 leke, me perdorimin e fondeve rezerve.

Urdheroj Zyren e Regjistrit Tregetar qe te behet shenim ne Skeden e Regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie ne kolonen 3, 4 dhe 5, duke u ndare regjistrimet me vije te kuqe nga njeri tjetri.

GJYQTARE

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR.VENDIMIT 13167/8
NR.DEPOZITIMIT

***V E N D I M***
***I GJYQTARIT TE VETEM***

Sot,me daten 08.07. 2004, unë gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kujtim Beqja, qe kerkon te beje ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre ne kapitalin e shoqerise "DORIAN" shpk si dhe te shtoje kapitalin shoqeror, dhe

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durrës, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe, aktualisht perbehet nga pese ortaket e shënuar me lart, qe perbejne Asamblene e Ortakeve dhe qe zoterojne secili prej tyre nga 20% te kuotave. Aktiviteti i kesaj shoqerie nuk ka ndryshuar dhe, kryesisht është ne fushen e prodhimit e te tregetimit te bojrave, administrator është Kujtim Beqja.

Ortaku Dhimitri Luleme, ka kerkuar qe te largohet nga pjesemarrja ne shoqeri dhe i ka ofruar pjesen e tij prej 20% te kuotave, ortakeve te tjere, te cilët janë dakord ti blejne ato ne menyre te barabarte ndërmjet tyre. Per kete është hartuar edhe kontrata perkatese e shitblerjes se kuotave dhe janë kryer likuidimet perkatese.

Keto ndryshime janë pasqyruar ne vendimin nr.7 date 3.06.2004 te Asamblese se Ortakeve dhe ne kontraten e shitblerjes se kuotave nr.575 nr.kol.94 date 3.06.2004.

Vec kesaj, duke pare ecurine e veprimtarise se shoqerise, Asambleja e Ortakeve ka vendosur te shtoje kapitalin themeltar. Per te bere te mundur fillim e procedurave, është menduar te emerohet si eksperte kontabel z.Nadire Hyseni, e cila është pajisur me licence si EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR, me ane te licences te Insitutit te Eksperteve. Kjo është pasqyruar ne vendimin nr.8 date 16.06.2004 te Asamblese se Ortakeve.

Ne baze te Ligjit , kerkesa është e drejte dhe prandaj duhet pranuar.

PER KETE ARESYE,

Bazuar ne nenin 21 te Ligjit nr.7632 date 4.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", ne nenet 45 e 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"dhe ne nenin 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993"Per Regjistrin Tregetar",

V E N D O S A

Depozitimin e vendimit nr.7 date 3.06.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DORIAN" shpk, qe ka vendosur te transferoje 20% te kuotave te kapitalit baraz me 20.000 leke nga ortaku Dhimitri Luleme tek ortaket Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodaj dhe Artan Beqja nga 5% secili duke u bere keshtu secili prej tyre me nga 25% te kuotave, si dhe te kontrates se shitjes se kuotave nr.575 date 3.06.2004, si dhe te vendimit nr.8 date 16.06.2004 per emerimin e ekspertit.

Urdheroj Zyren e Regjistrit Tregetar qe te behet shenim ne Skeden e Regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie ne kolonen 3, 4 dhe 5, duke u ndare regjistrimet me vije te kuqe nga njeri tjetri.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR.VENDIMIT 13167/8
NR.DEPOZITIMIT

***VENDIM***
***I GJYQTARIT TE VETEM***

Sot,me daten 08·07 2004, unë gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kujtim Beqja, qe kerkon te beje ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre ne kapitalin e shoqerise "DORIAN" shpk si dhe te shtoje kapitalin shoqeror, dhe

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durrës, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe, aktualisht perbehet nga pese ortaket e shënuar me lart, qe perbejne Asamblene e Ortakeve dhe qe zoterojne secili prej tyre nga 20% te kuotave. Aktiviteti i kesaj shoqerie nuk ka ndryshuar dhe, kryesisht është ne fushen e prodhimit e te tregetimit te bojrave, administrator është Kujtim Beqja.

Ortaku Dhimitri Luleme, ka kerkuar qe te largohet nga pjesemarrja ne shoqeri dhe i ka ofruar pjesen e tij prej 20% te kuotave, ortakeve te tjere, te cilët janë dakord ti blejne ato ne menyre te barabarte ndërmjet tyre. Per kete është hartuar edhe kontrata perkatese e shitblerjes se kuotave dhe janë kryer likuidimet perkatese.

Keto ndryshime janë pasqyruar ne vendimin nr.7 date 3.06.2004 te Asamblese se Ortakeve dhe ne kontraten e shitblerjes se kuotave nr.575 nr.kol.94 date 3.06.2004.

Vec kesaj, duke pare ecurine e veprimtarise se shoqerise, Asambleja e Ortakeve ka vendosur te shtoje kapitalin themeltar. Per te bere te mundur fillim e procedurave, është menduar te emerohet si eksperte kontabel z.Nadire Hyseni, e cila është pajisur me licence si EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR, me ane te licences te Insitutit te Eksperteve. Kjo është pasqyruar ne vendimin nr.8 date 16.06.2004 te Asamblese se Ortakeve.

Ne baze te Ligjit , kerkesa është e drejte dhe prandaj duhet pranuar.

PER KETE ARESYE,

Bazuar ne nenin 21 te Ligjit nr.7632 date 4.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", ne nenet 45 e 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"dhe ne nenin 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993"Per Regjistrin Tregetar",

VENDOSA

Depozitimin e vendimit nr.7 date 3.06.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DORIAN" shpk, qe ka vendosur te transferoje 20% te kuotave te kapitalit baraz me 20.000 leke nga ortaku Dhimitri Luleme tek ortaket Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodaj dhe Artan Beqja nga 5% secili duke u bere keshtu secili prej tyre me nga 25% te kuotave, si dhe te kontrates se shitjes se kuotave nr.575 date 3.06.2004, si dhe te vendimit nr.8 date 16.06.2004 per emerimin e ekspertit.

Urdheroj Zyren e Regjistrit Tregetar qe te behet shenim ne Skeden e Regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie ne kolonen 3, 4 dhe 5, duke u ndare regjistrimet me vije te kuqe nga njeri tjetri.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. VENDIMIT 13167/10

## ***VENDIM***
## ***I GJYQTARIT TE VETEM***

Sot, me daten 26. 10. 2006, une gjyqtarja e Gjykates te Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori Kujtim Beqja, i shoqerise "DORIAN" shpk, dhe

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22./12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane. Kjo shoqeri ka bere disa here ndryshime qe konsistojne ne emertimin e shoqerise, ne ortaket pjesemarres, ne kuotat e tyre te kapitalit dhe ne zmadhimin e kapitalit. Aktualisht kjo shoqeri ka nje kapital prej 5.000.000 leke dhe perbehet nga ortaket Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodo dhe Artan Beqja me nga 25% te kuotave te kapitalit secili.

Asambleja e Ortakeve, me vendimin e saj nr.9 date 06.11.2006 ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit ne natyre.
2. Te emeroje z.Rifat Muco, si EKSPERT KONTABEL TE AUTORIZUAR per vleresimet.

Ne baze te Ligjit, kerkesa eshte e drejte dhe prandaj duhet pranuar.

PER KETE ARESYE

Bazuar ne nenin 21 te Ligjit nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", ne nenet 45 e 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe ne nenin 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin Tregetar",

VENDOSA

Depozitimin e vendimit nr.9 date 06.11.2006 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DORIAN" shpk, qe ka vendosur zmadhimin e kapitalit ne natyre dhe te emeroje z.Rifat Muco, si ekspert kontabel i autorizuar.

Urdheroj Zyren e Regjistrit Tregetar qe te beje shenim ne Skeden e regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. VENDIMIT 13167/11

***VENDIM***
***I GJYQTARIT TE VETEM***

Sot, me daten 7/3/ 2007, une gjyqtarja e Gjykates te Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori Kujtim Beqja, i shoqerise "DORIAN" shpk, dhe

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22./12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane. Kjo shoqeri ka bere disa here ndryshime qe konsistojne ne emertimin e shoqerise, ne ortaket pjesemarres, ne kuotat e tyre te kapitalit dhe ne zmadhimin e kapitalit. Aktualisht kjo shoqeri ka nje kapital prej 5.000.000 leke dhe perbehet nga ortaket Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodo dhe Artan Beqja me nga 25% te kuotave te kapitalit secili.

Me vendimin ***nr.9 date 6.11.2006*** te Asamblese se Ortakeve, eshte vendosur:

***Zmadhimi i kapitalit dhe emerimi*** i z.Rifat Muço, si ***ekspert kontabel i autorizuar.***

Me vendimin nr.***13167/10 date 26.12.2006*** te gjyqtarit te vetem, eshte ***vendosur depozitimi*** i vendimit te mesiperm.

Eksperti kontabel i autorizuar ka hartuar Akt-ekspertimin e tij ku vertetohet qe kapitali ne natyre i kesaj shoqerie mund te zmadhohet duke u bere 10.000.000 leke nga 5.000.000 leke qe eshte aktualisht, pasi 10.000.000 leke eshte vlera ne natyre e kapitalit te shoqerise. Ky ***aktekspertimi eshte miratuar*** nga Asambleja e Ortakeve me vendimin e saj ***nr.10 date 30.12.2006.***

Vec, kesaj Asambleja e Ortakeve, mendon qe te shtoje aktivitetin e shoqerise edhe me aktivitet ne fushen e ndertimit per vete, sipas licences qe do te leshohet nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve. Per kete qellim, pasi eshte punesuar drejtuesi teknik, Inxhinjer Ulsi Toqi, i pajisur me Licence profesionale nr.Z1666/4, Asambleja e Ortakeve me vendimin ***nr.11 date 24.01.2007***, ka miratuar ***shtimin*** e aktivitetit te shoqerise me ***aktivitet ne fushen e ndertimit per vete***.

Nga kjo shoqeri eshte kerkuar depozitimi i vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.10 date 30.12.2006 si dhe i vendimit nr.11 date 24.01.2007.

Kerkesa eshte e mbeshtetur ne ligj, prandah duhet te pranohet.

PER KETE ARESYE

Bazuar ne nenin 21 te Ligjit nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", ne nenet 45 e 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe ne nenin 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin Tregetar",

V E N D O S A:

1. Depozitimin e vendimit nr.10 date 30.12.2006 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DORIAN" shpk, qe ka vendosur miratimin e aktekspertimit per rritjen e kapitalit prej 5.000.000 leke qe eshte sot me 5.000.000 leke te tjera duke u bere keshtu 10.000.000 leke.

2. Depozitimin e vendimit nr.11 date 24.01.2007te asamblese se Ortakeve te shoqerise DORIAN shpk, per shtimin aktivitetin e shoqerise edhe me aktivitet ne fushen e ndertimit per vete, sipas licences qe do te leshohet nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Urdheroj Zyren e Regjistrit Tregetar qe te beje shenim ne Skeden e regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie.

GJYQTARE

Majlinda Dogjo

Vendimi regjistrimi

1

13167

1.

2. a) "Durres" Sh.p.k.
b) L. 14, Durrës
c) Prodhim dhe tregtim te bojrave te ≠ l. dhe materialeve te ndertimit, parafabrikate etj.
Eksp-imp etj.
d) 100 000 lekë
50% Dhimiter Bezaitis
50% Fedhon Jovanidhis

3- Adm: Dhimiter Bezaitis, dtl 1949, banues ne Athine

4. 10 vjet
ati 2 fl
st 5 fl.

5- 16.12.95
22.12.95

Kapitali 135000

Çertifikatë depozitimi 13167

- Me vendim të Gj. Rr. Tiranë Nr. 13167.
eshte regjistruar si Shoqeri "Durresi" shpk me ortakë:
- Dhimitri Zeqiria
- Fedhon Ioannides

- Me vendim të Asamblesë Nr 1 dt. 14.3.96
Largimi i ortakut Fedhon Ioannidis
Pranimi si ortak i ri Sotirios Sotiropulos.
Kontratë shitje Nr-6605/2066.
dt 12-6-1996.

Të depozitohen: kopje e vendimit i Asamblesë, kontrata e shitjes

2579
dt 14/06/1996

dt. 14-6-96

Sekretar.
Magdalena Deshi

**JANI Z. LEZO**
**AVOKAT**
RR. A. Goga 71 - Tel. 221.76
Durres - Albania

AKT THEMELIMI

Ne Durres sot me daten 15 Dhjetor 1995 para meje avokatit Jani Lezo me qender ne Durres,u paraqiten:

1.DIMITER BEZAITIS i biri i Kostandinit shtetas grek me banim ne Athine me pasaport Nr.K 420113X,

2.FEDRON IOANIDHIS i biri i Nikollaut,shtetas grek me banim ne Athine me pasaport Nr.K 460472,

te cilet kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi si me posht

Nenik 1

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar,e cila emertohet "DURRES sh.p.k."".

Neni 2

Shoqeria "DURRES sh.p.k." do te kete qendren e vet ne qytetin e Durresit lagja Nr.14 ne teritorin e Uzines se elektrodave.

Ne baze te dispozitave ligjore dhe te statutit te saj,shoqeria mund te krijoje edhe dege,filiale e zyra perfaqesimi si ne qytete te tjera te Shqiperise edhe jashte saj.

Neni 3

Kohezgjatja ,e veprimtarise se shoqerise me kete akt themelimi caktohet per 15 (pesembedhjete) vjete,duke patur si fillim daten e regjistrimit te saj ne organet kompetente shqiptare dhe si date mbarimi daten 31 Dhjetor te vitit 2010.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Prodhimin dhe tregetimin e bojrave te ndryshme,si dhe te materialeve te tjera te ndertimit.

- Prodhimin dhe tregetimin ne forme import eksport te parafabrikateve te ndryshme per sektorin e ndertimit te banesave,objekteve te karakterit industrial dhe shoqeror.

- Ushtrimin e tregetise ne forme import eksporti ,me shumice dhe me pakice te mallrave nga te gjitha llojet pa kufizim,si te mallrave industriale,makineri e pajisje,pjese kembimi per industrine dhe automjete,aparatura elektroshtepijake,artikuj ushqimore te cdo lloji,produ

me bujqesore e blegtorale,produime farmaceutike per njerezit,kafshet dhe per bimet, si dhe te lidh marreveshje perfaqesimi per marrjen e kredive nga bankat e K.E.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise caktohet ne shumen 100 .000 (njeqinde mije) leke,i cili formohet dhe nenshkruhet ne kete menyre:

Ortaku DHIMITRI BEZATIS 50.000 leke ose 50 perqinde te tij.

Ortaku FEDHON IOANIDHIS 50.000 leke ose 50 perqinde te tij.

Ky kapital ndahet ne kuota te barabarta me vlere nga 1000 leke secila dhe secili nga ortaket disponon aq kuota sa eshte pjesemarrja e tij ne kapitalin e shoqerise.

Neni 6

Administrator i shoqerise me kete akt themelimi caktohet Zoti DHIMITRI BEZAITIS.

Me vendim te Asamblese se ortakeve,mund te emerohen edhe administratore te tjere,edhe pagene ortake.Gjithashtu mund te caktohen edhe eksperte e specialiste te tjere sipas nevojave.

Nen i 7

Pasuria e shoqerise eshte ne bashkepronesi te dy ortakeve ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise.Kjo pasuri administrohet ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe te statutit te shoqerise per plotesimin e qellimit dhe objektit te shoqerise.

Neni 8

E gjithe veprimtaria e shoqerise mbeshtetet ne legjislacionin shqiptar,ne dispozitat e statutit te saj dhe funksionon si person juridik shqiptar.

Neni 9

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje te njejta dhe pasi u lexua dhe u gjet konforme vullnetit te tyre firmoset nga ortaket.

ORTAKET THEMELUES

DHIMITRIK BEZAITIS FEDHON IOANIDHIS

**JANI Z. LEZO**
**AVOKAT**
RR. A. Goga 71 - Tel. 221.76
Durres - Albania

# STATUTI

## I SHOQERISE "DURRES sh.p.k."

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DURRES sh.p.k." e themeluar prej ortakeve:

1.DHIMITRI BAZAITIS i biri i Kostandinit i datelindjes 27.I.194 ,shtetas grek me banim ne Athine dhe aktualisht ne Durres,me pasaport Nr.K.420113.

2.FEDHON IOANIDHIS i biri i Nikollaut,shtetas grek me banim ne Athine me pasaport Nr.K 460473,i datelindjes29.03.1953.

do te funksionoje ne baze te legjislacionit shqiptar dhe do te administrohet ne baze te dispozitave te ketij statuti.

## EMERTIMI

### Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar emertohet "DURRES sh.p.k.", emertim i cili do te jete ne emblemen e shoqerise,ne vulen e saj dhe ne te gjitha dokumentat qe do te hartohen prej saj.

## SELIA

### Neni 2

Shoqeria "DURRES sh.p.k." e ka qendren e saj ne qytetin e Durresit ne lagjen Nr.14 ne teritorin e Uzines se Elektrodave,ku do te jete qendra administrative e shoqerise.

Me vendim te Asamblese se ortakeve dhe ne baze te legjislacionit ne fuqi,shoqeria mund te krijoje edhe dege,filiale e zyra perfaqesimi si ne qytete te tjera te Shqiperise ,por edhe jashte saj.

## KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

### Neni 3

Shoqeria do te kryej veprimtarine e saj ekonomiko-financiare per nje periudhe prej 15 vjetesh.Sidate fillimi eshte data e fitimit te personalitetit juridik me regjistrimin e saj ne Gjykaten e Tiranes (Regjistri Tregtar) dhe si date mbarimi daten 31 Dhjetor te vitit 2010

Me vendim te Asamblese se ortakeve shoqeria mund te shperbehet para mbarimit te afatit,ose mund te zgjas veprimtarine e saj edhe per nje periudhe tjeter,sipas vendimit te asamblese.

## OBJEKTI I SHOQERISE

### Neni 4

Shoqeria "DURRES sh.p.k." do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

- Prodhimin dhe tregetimin e bojrave te ndryshme si dhe te materialeve te tjera te ndertimit.
- Prodhimin dhe tregetimin ne forme import eksporti te parafabrikateve te ndryshme per sektorin e ndertimit te banesave,objekteve te karak terit industrial dhe shoqeror.
- Ushtrimin e tregetise ne forme import eksport,me shumice e

me pakice te mallrave nga te gjitha llojet pa kufizim,si te mallrave industriale,makineri e pajisje,pjese kembimi per industrine dhe automjetet,aparatura elekttoshtepijake,artikuj ushqimore te çdo lloji,prodhime bujqesore e blegtorale,prodhime farmaceutike per njerezit,kafshet dhe bimet.

Shoqeria mund te lidh marreveshje perfaqesimi per sigurimin dhe marrjen e kredive nga bankat e K.E.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise caktohet ne shumen 100.000 (nje qinde mije) leke dhe formohet e nenshkruhet ne kete menyre:

Ortaku DHIMITRI BAZAITIS nenshkruan dhe depoziton 50.000 leke qe perfaqeson 50 perqinde te kapitalit themeltar.

Ortaku FEDHON IOANIDHIS nenshkruan dhe depoziton 50.000 leke qe perfaqeson 50 perqinde te kapitalit te shoqerise.

Ky kapital ndahet ne kuota te bababarta me vlere 1000 leke secila dhe çdo ortak ka te drejte te zoteroje aq kuota sa eshte pjesemarrja e tij ne kapitalin e shoqerise.

Kuotat e kapitalit mund te shiten lirisht midis ortakeve sipas vleres se pergjithshme te realizuar deri ne ate moment nga shoqeria. Oferta behet me shkrim dhe u behet e njohur te gjithe ortakeve qe jane te regjistruar ne librin e ortakeve,duke ju lene nje kohe prej 20 ditesh per te vendosur. Me mbarimin e ketij afati,ortaku shites,edhe pa marre pergjigje nga ortaket ose shoqeria,ka te drejte te shes kuotat e tija tek te tretet.

Ne rast vdekje te ortakut,kuotat e tij u kalojne trashegimtare te tij ne baze te dispozitave mbi trashegimine.Keta te fundit hyjne me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e ortakut te vdekur.

Neni 6

Shoqeria eshte pronare e mjeteve dhe e pasurise se saj.Te gjithe ortaket jane bashkepronar ne pasurine e shoqerise ne raport me kuotat qe disponojne ne kapitalin e shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te disponoje pasurine dhe mjetet e saj ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj dhe ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Neni 7

Adresa e ortakeve,persa i perket marredhenieve te tyre me shoqerine eshte ajo qe eshte shenuar ne librin e ortakeve.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 8

Asambleja e olrtakeve e formuar rregullisht dhe e thirur ne baze te ligjeve dhe te dispozitave te ketij statuti,eshte organ sovran i shoqerise.

Njoftimet per thirjen e Asamblese duhet te behen nga administratori,te behen me shkrim dhe jo me pak se 10 para dates se mbledhjes.

Ne njoftimet duhet te shenohet vendi i mbledhjes,data dhe ora e sak dhe rendi i dites i shoqeruar me dokumentacionin perkates.

Mbledhjet e Asamblese mund te behen edhe jashte qendres se shoqerise ,sipas njoftimit te bere.

Vendimet e Asamblese te marra konforme ligjit dhe sipas dispozitave te ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithe ortaket edhe per ata qe kane votuar kundra ose kane munguar.

Neni 9

Mbledhjet e Asamblese jan e te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Mbledhjet e zakonshme behen te pakten nje here ne vit per te shqyrtuar bilancin vjetor te shoqerise dhe per te vendosur per problemet qe lidhen me te.

Mbledhjet e jashtezakonshme mblidhen sa here shikohet e nevojshme. Keto thiren nga administratori i shoqerise dhe nga ortaket qe perfaqesone te pakten 20 perqinde te kapitalit te shoqerise.

Neni 10

Asambleja e ortakeve vendos detyrimisht per keto probleme:

- Per te bere ndryshime ne statutin e shoqerise.
- Per rritjen e kapitalit te shoqerise ose per pakesimin e tij.
- Per pranimin e ortakeve te rinje ne shoqeri.
- Per mbarimin e shoqerise para mbarimit te afatit te caktuar ne aktin e themelimit dhe per kalimin ne likujdim.
- Per zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise.
- Per menyren e ndarjes se fitimeve dhe perdorimin e fondit te domosdoshem.

Per te gjitha keto probleme vendimet merren me votimin "PRO" te 3 /4 e kapitalit te shoqerise.

Neni 11

Ne mbledhjet e Asamblese kane te drejte te marrin pjese ortaket qe jane te regjistruar ne librin e ortakeve.Secili nga ortaket mund te perfaqesohet ne mbledhje edhe nga nje ortak tjeter ose nga çdo person tjete r ne baze te nje prokure noteriale.

Neni 12

Per drejtimin e mbledhjes se Asamblese zgjidhet nje kryetar qe ne fillim te mbledhjes.Zgjidhet edhe nje sekretar per mbajtjen e proces verbalit.Proces verbali mund te mbahet edhe nga nje noter sipas percaktimit te asamblese.

Proces verbali dhe vendimet e Asamblese duhet te firmosen nga kryetari dhe sekretari ose noteri.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 13

Per administrimin e shoqerise emerohet administratori,i cili fillimisht caktohet ne aktin e themelimit,i cili qendron ne detyre per nje vit dhe eshte i rizgjedhshem.

Me vendim te Asamblese emerohet administratori,i cili mund te jete edhe jo ortak.

Neni 14

Administratori i shoqerise kryen te gjitha detyrat e administri mit te zakonshem te shoqerise dhe ka te drejten e firmes se pare dhe te perdorimit te vules.Ai perfaqeson shoqerine ne te gjitha organet shteterore dhe gjyqesore,si dhe ne marredheniet me te tretet.Ai ka te drejte te firmos kontrata e marreveshje qe kane te bejne me zbatimin e qellimit dhe objektit te shoqerise.

VEPRIMTARIA EKONOMIKO-FINANCIARE

Neni 15

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise realizohet ne baz te rregullave te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi.

Per kryerjen e veprimeve financiare emerohen specialiste,kompe tencat dhe menyra e pageses se tyre caktohen ne aktin e themelimit.

Neni 16

Periudha ekonomiko-financiare e shoqerise mbyllet me daten 31 Dhjetor te çdo viti.Ne fund te çdo periudhe veprimtarie ekonomiko-financiare administratori duhet te pergatis bilancin e shoqerise sipas afateve dhe menyres se percaktuar ne ligj.

Bilanci i çdo periudhe i shoqeruar me nje relacion te hollesi-shem dhe me dokumentat perkatese,duhet ti paraqitet mbledhjes se Asambl se se ortakeve nga administratori brenda tre muajve nga mbyllja e vepr mtarise per periudhen konkrete.

Neni 17

Fitimi qe rezulton nga bilanci i shoqerise do te ndahet sipas menyres se meposhtme:

5 perqinde e fitimit veçohet si "rezerve e domosdoshme" dhe mu te perdoret vetem me vendim te Asamblese se ortakeve.

Pjesa tjeter e fitimit u takon ortakeve ne formen e dividentev dhe perdoret sipas vendimit te tyre.

Sejcilit nga ortaket i takon te marre nga fitimi i shoqerise ne proporcion me perqindjen e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise. Ne kete perqindje ata jane pergjegjes edhe per detyrimey e shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 18

Aktiviteti i shoqerise merr fund kur:

- Mbaron afati i percaktuar ne aktin e themelimit.

- Vendoset shperberja e shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve para mbarimit te afatit.

- Kur bilancet kontabel te shoqerise rezultojne se veprimtaria e saj nuk eshte rentabile.

Neni 19

Kur arrihet ne konkluzi on se shoqeria duhet te shperbehet, Asambleja e ortakeve,ne perputhje me ligjin,vendos per emerimin e likuj datoreve.Ne aktin e emerimit te tyre percaktohen kompetencat dhe menyra e shperblimit te tyre.

## MBESHTETJA LIGJORE

### Neni 20

E gjithe veprimtaria e shoqerise mbeshtetet ne legjislacionin shqiptar dhe ne menyre te veçante ne:

- Ligjin Nr.7638 date 19.XI.1992 "Per shoqerite tregtare".
- Ligji Nr.7667 date 28.I.1993
- Ligji Nr.7850 date 29.7.1994 KreuXXII "Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise.
- Ne dispozitat e ketij statuti.

Problemet qe nuk jane parashikuar shprehimisht ne kete statut zgjidhen ne baze te dispozitave ligjore.

### Neni 21

Ky statut u redaktua dhe u miratua nga ortaket themelues dhe eshte i detyrueshem per zbatim nga te gjithe ortaket e shoqerise.

Cdo ndryshim ne dispozitat e ketij statuti mund te behen me vendim te asamblese se ortakeve, ndryshim i cili duhet te pasqyrohet edhe ne regjistrin tregtar.

ORTAKET THEMELUES:

DHIMITRI BEZAITIS FEDHON IOANIDHIS

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr.rep. 6760 Nr.kolek. 1669

## V E R T E T I M

Ne Durres sot me daten 16.12.1995 para meje Lindita Lula notere me qender ne Durres u paraqiten/DHIMITRI BEZAITIS i biri i Kostandinit i datelindjes 27.I.1949 shtetas grek me banim ne Athine dhe me banim provizor ne Durres me pasaport Nr. K 420113 dhe FEDHON IOANIDHIS i biri i Nikollaut i datelindjes 29.03.1953 shtetas grek me banim ne Athine me pasaport Nr.K 460472, te dy me zotesi te plote per te vepruar, te cilet ne pranine time firmosen kete statut. Une noteria vertetoj.

PULLE TAKSE RESHQIPERISE

NOTERE

(Lindita Lula)

PULLE TAKSE

# STATUTI ( i ndryshuar)

## I SHOQERISE "DORIAN"shpk NE DURRES

(miratuar nga Asambleja e Ortakeve te kesaj shoqerie me date 4.8.99)

Shoqeria e mesiperme eshte e perbere nga ortaket e poshteshenuar:

1. Kujtim BEQJA, i datelindjes 7.11.1957,lindur dhe banues ne Tirane
2. Christos SPILIOTOPOULOS, dtl.9.05.1940,ne Attikis,banues ne Athine
3. Dhimitri LULEME, dtl.1.07.1964, lindur ne Gjirokaster,banues ne Kavaje.
4. Milto HODAJ, dtl.28.12.1962,lindur dhe banues ne Mallakaster.
5. Artan BEQJA, dtl.27.02.1966,lindur dhe banues ne Tirane.

dhe be baze te vendimit te Asamblese se ortakeve harton kete statut te ndryshuar.

### KREU I

### DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

a) Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar.

b) Shoqeria eshte person juridik, personalitet te cilin e ka fituar me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar me vendimin nr. 13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane.

Neni 2

a) Shoqeria eshte emertuar "DORIAN"shpk.

b) Qendra e saj eshte ne Durres.

Neni 3

a) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin me mjetet e veta financiare dh me b rime te ligjeshme financimi.

b) Shoqeria do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe sipas rregullave te caktuara ne kete statut.

### KREU II

Neni 4

a) Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte;

- Prodhim dhe tregetim bojrash.
- Import eksport, tregetim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme industriale.

NOTERE DURRES



b) Ne keto aktivitete shoqeria do te veproje edhe duke kryer investimet e duhura ne rast nevoje.

c) Ne te ardhmen objekti i aktivitetit mund te shtohet me aktivitete te tjera te lejuara nga ligji.

KREU III

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

a) Shoqeria e fillo aktivitetin e saj pas marrjes se lejes perkatese dhe regjistrimit neorganet perkatese shteterore.

b) Ne rast se 6 muaj nga data e regjistrimit, shoqeria nuk ka filluar aktivitetin e saj, çdo ortak ka te drejte t'i drejtohet gjykates per te kerkuar prishjen e shoqerise dhe terheqjen e pjeses se derdhur prej tij ne kapitalin fillestar.

Neni 6

a) Kohezgjatja e shoqerise eshte parashikuar mbi 10 vjet.

b) Ne rast se 6 muaj para ketij afati nuk kerkohet nga ndonjeri prej ortakeve likuidimi i shoqerise, kjo kohezgjatje konsiderohet automatikisht si e zgjatur edhe 5 vjet te tjera dhe keshtu çdo pesevjeçar pa,kufizim.

KREU IV

KAPITALI THEMELOR

Neni 7

a) Kapitali shoqeror ne momentin e themelimit eshte IOO.000 lekė te ndara ne IOO kuota me nga 1000 leke fillimisht.

b) Kuotat i perkasin ortakeve si me poshte:

- Z. Dh.Luñieme ka 20 kuota baraz me 20.000 leke.
- Z. K. Beqja ka 20 kuota baraz me 20.000 leke .
- Z.M. Hodaj ka 20 kuota baraz me 20.000 leke.
- Z. A.Beqja ka 20 kuota baraz me 20.000 leke.
- Z.SPILIOTOPOULOS ka 20 kuota baraz me 20.000 leke.

c) Kapitali shoqeror mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas

NOTERE DURRES



interesave te shoqerise, por ai nuk mund te zbrese nen kufirin minimal te percaktuar nga ligji.

d) Percaktimi i kuotave te kapitalit ne monedhe shqiptare dhe te huaj, do te behet sipas kursit te kembimit ne kohen e lindjes se nevojes per kete kembim.

e) Kapitali shoqeror mund te jete ne leke ose ne vlera materiale. Vleresimi i kontributeve ne natyre behet me unanimitetin e ortakeve ose nga nje ekspert i emeruar sipas ligjit.

f) Kuotat e kapitalit nuk perfaqesoje kontribute ne sherbime .

g) Kuotat e kapitalit nuk perfaqesohen ne çeqe, letra krediti, kambiale,etj. te ketij lloji.

Neni 8

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ne menyrat e meposhteme:

a) me sjelljen direkte nga ortaket ne proporcion me kuotat e tyre te kapitalit.

b) me perdorimin e fitimeve te pashperndara me pare dhe me perdorimin e fondeve rezerve.

c) me menyra te tjera te lejuara nga ligji.

Neni 9

a) Ne asamblene e ortakeve, secili ortak ka te drejte vote perpjesetimisht me kuotat qe zoteron ne kapitalin shoqeror, ku çdo ortak ka nje vote per çdo 1000 lek.

b) Ne rast te likuidimit te shoqerise, mbetja qe mund te rezultoje i ndahet ortakeve proporcionalisht me kuotat e kapitalit.

Neni 10

Ne rastte heqjes dore nga kuotat te ndonjeri prej ortakeve, ortaket e tjere mund te ushtrojne te drejten e parablerjes.

Neni 11

Transferimi i kuotave perkatese, pjeserisht ose teresisht behet:

a) lirisht ndermjet ortakeve.

b) me trashegimi, ndermjet bashkeshoreteve e pas e paralindurve

Asambleja e ortakeve mund te vendose kushtet e transferimit,

te cilat nuk mund te jene me pak te favoreshme sesa ato per te tretet.

c) personave te trete, me aprovimin e nje shumice prej 3/4 te kuotav te kapitalit.

## KREU V

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

Neni I2

Ortaku ka te drejte:

a) te marre pjese ne aktivitetin e shoqerise.

b) te perfitoje nga fitimi i realizuar ne nje mase proporcionale me kuotat e zoteruara prej tij ne kapitalin shoqeror.

c) te informohet dhe konsultohet me librat e shoqerise.

d) te kerkoje nga gjykata anullimin e vendimeve te marra nga asambleja te cilat vijne ne kundershtim me ligjin dhe me kete statut.

e) te perfitoje nga kuota e kapitalit dhe nga fitimi deri ne diten e largimit ose te likuidimit te shoqerise.

Neni I3

Ortaku ka per detyre:

a) te derdhe kuoten e tij ne kapitalin shoqeror.

b) te njohe dhe zbatoje dispozitat e ketij statuti.

c) te marre pjese ne administrimin e aktivitetit te shoqerise.

d) te veproje per arritjen e qellimit te shoqerise.

e) te mbikeqyre zbatimin e vendimeve te marra nga asambleja e ortakev

f) te marre pjese, ne proporcion me kuoten e tij te kapitalit, ne plotesimin e humbjeve .

Neni 14

1. Pjesamarrja ne shoqeri pushon ne rast te:
   a) vdekjes se ortakut
   b) paaftesise per shkak semundje mendore
   c) likuidimit vullnetar te shoq erise.
   d) largimit vullnetar nga shoqeria.
   e) falimentimit te shoqerise.
   f) ne raste te tjera te percaktuara nga ligji.

2. Vlera e kuotes dhe fitimit te ortakut ne rastet e parashikuara nga germat"a","b" dhe "d" te pikes 1, percaktohet ne baze te rezultatit kontabel ne fund te muajit ne te cilin ka ndodhur ngjarja.

Neni 15

a) Aprovimi i ortakeve te rinj, percaktohet nga asambleja pas shqyrtimit te kerkeses perkatese me shkrim, ne te cilen perveç te tjerave pranohen normat e ketij statuti.

b) Largimi i ortakut behet pas shqyrtimit te kerkeses perkatese me shkrim. Ne kete rast shoqeria duhet te llogarise kuoten e kapitalit dhe fitimit qe duhet t'i likuidoje ortakut qe largohet

c) Largimi i nje ortaku, nuk e perjashton ate nga detyrimet e kerkueshme deri ne daten e largimit nga shoqeria.

Neni 16

Pasuria e shoqerise eshte ne pronesi te ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre ne kapitalin shoqeror.

Neni 17

Kuotat mund te transferohen me rruge trashegimie ne perputhje me dispozitat ne fuqi ne diten e transferimit.

KREU VI

ORGANET E SHOQERISE

Neni 18

Organet e shoqerise jane:

a) Asambleja e ortakeve
b) administratori
c) ekspertet revizore

Neni 19

a) Asambleja e ortakeve eshte formuar nga te gjithe ortaket e shoqerise dhe eshte organ vendimor, organi me i larte i shoqeri

b) Asambleja e ortakeve merr ne shqyrtim dhe vendos per te gjitha probleme t e shoqerise dhe ka edhe kompetenca ekskluzive si:

a1. vendos per ndryshimet ne statut.
a2. miraton hyrjen e ortakeve te rinj.

...TERE DURRES



a3. shqyrton te drejten e parablerjes se rast transferimi te kuotave.

a4. miraton bilancin vjetor dhe vendos per rezultatin.

a5. vendos per shtimin dhe pakesimin e kapitalit.

a6. vendos pe r likuidimin e shoqerise.

a7. vendos per hapjen e filialeve te reja dhe mbylljen e atyre ekzistuese.

a8. zgjedh administratorin dhe ekspertet.

a9. vedos per pjesemarrjen e mundeshme ne shoqeri te tjera.

a10. vendos per shitjen dhe blerjen e pasurivete paluajteshme te shoqerise.

a11. vendos per organizimin e brendshem te shoqerise.

a12. vendos lidhur me perputhshmerine e investimeve te nevojeshme me zhvillimin strukturor te shoqerise.

Neni 20

a) Asambleja vendos me shumic e votash qe perfaqesojne shumicen e kapitalit te shoqerise, me perjashtim te raste e kur ligji kerkon nje shumice te kualifikuar.

b) Eshte e detyrueshme shumica e kualifikuar prej 3/4 te kapitalit shoqeror ne kete raste:

- transferimi i kuotave te treteve
- ndryshimet ne statut.
- pakesimi i kapitalit
- ndryshimi i shoqerise ne shoqeri anonime.

Neni 21

a) Asambleja eshte e zakoneshme dhe e jashtezakoneshme sipas ligjit.

b) Ajo mund te thirret edhe jashte qendren se shoqerise.

c) Thirrja e asamble e behet nga administratori dhe mund te kerkohet edhe nga nje ose me shume ortake te cilet perfaqesojne me shume se 10 perqind te kapitalit shoqeror.

d) Thirrja e asamblese behet me ane te letres rekomande ose me çdo mjet tjeter, ne menyre qe ortaket te njoftohen per kete te pakten I5 dite para dates se mbledhje s.

e) Gjithsesi, mbledhja do te konsiderohet e vlefshme, ne rast se te gjithe ortaket jane prezent ose te perfaqesuar.

f) Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter, por ai nuk mund t'i delegoje perfaqesuesit te drejten te votoje per nje pjese te kuotave duke ruajtur per vete pjesen tjeter.

Neni 22

Administrimi i perditshem i shoqerise behet nga nje administrator i vetem qe eshte z. Kujtim Beqja.

Ai perfaqeson shoqerine para organe ve shteterore dhe private .

Neni 23

Administratori ka kompetence te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise kundrejt te treteve, me perjashtim te kompetencave qe ka asambleja e ortakeve. Ne llogarite bankare te shoqerise, ai ka te drejte te kryeje veprime deri ne shumen 500.000 leke, nderse per shuma me te medha duhet te marre paraprakisht miratimin e asamblese se ortakeve.

Neni 24

Nder detyrat e administratorit jane edhe keto :

a- te kryeje ne emer dhe per llogari te shoqerise veprime si lidhja e kontratave dhe marreveshjeve, perfaqesimi i shoqerise ne organet dhe entet shteterore, administrative, ekonomike, gjyqesore, financiare, fiskale, doganore, kundrejt personave juridike dhe shtetasve. Keto veprime ai mund t'i kryeje vete ose edhe nga perfaqesues me ane te prokures se posaçme.

b) te kujdeset per hartimin e librave dhe regjistrave te shoqerise, ne te cilet regjistrohen pasurite e shoqerise dhe aktiviteti i saj si dhe te bilancit te shoqerise me llogarine fitime e humbje.

c- eshte i detyruar te informoje asamblene e ortakeve per aktivitetin e tij gjate periudhes ndermjet dy mbledhjeve te saj.

Neni 25

a) Asambleja e ortakeve ka te drejte te ndryshoje dhe te anulloje veprimet e administratorit, te cilat nuk perputhen me ligjin dhe me kete statut, duke vendosur edhe per pasojat ndaj te treteve ne menyre qe ato te jene minimale.

b) Shoqeria nuk pergjigjet per pasojat ndaj te treteve ne rast se pravohet qe ata ishin ne dijeni te faktit qe akti i administratorit nuk ishte ne perputhje me ligjin ose me statutin.

c) Ne kontrata e pergjitheshme ose ne ato me karakter te veçante, eshte e nevojeshme te merret edhe miratimi i asamblese. Ky miratim mund te merret edhe me vone dhe ka nje fuqi prapaveprues.

Neni 26

a) Ekspertet emerohen duke i zgjedhur ndermjet personave te besuar dhe me aftesi profesionale edhe jashte bashkesise se ortakeve, me perjashtim te atyre qe ndalohen me ligj.

b) Ekspertet kaneper detyre te kontrollojne zbatimin e normave te ketij statuti, te ligjeve, mbajtjen e rregullt te regjistrave dhe plotesimin e sakte te operacioneve te ndryshme, per te gjitha keto i raporton asamblese se ortakeve.

Neni 27

a) Asambleja e ortakeve percakton shperblimet qe u takojne ekspe-rteve dhe administratorit.

b) Shperblimet per personelin varte s percaktohen nga kontratat e punes te lidhura ndermjet administratorit dhe punonjesit.

KREU VII

AKTIVITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR

Neni 28

Qellimi i shoqerise eshte mbulimi i shpenzimeve dhe realizimi i fitimeve.

Neni 29

Per te realizuar qellimin e saj shoqeria mund te kryeje edhe keto veprime:

a) te hape depozita dhe llogari prane bankave dhe insitucioneve te tjera te kreditit.

b) te marre hua nga bankat dhe nga persona te veçante.

c) te lidhe kontrata dhe aktete tjera sipas ligjit dhe interesave te saj.

d) te hape filiale, seksione, agjensi dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te tjera te vendit.

e) te kete pasuri te paluajteshme, te cilat regjistrohen prane zyrave kompetente sipas ligjit.

f) te marre pjese ne shoqeri te tjera.

Neni 30

a) Viti financiar çelet me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti.

b) Brenda kater muajve nga mbyllja e tij, administratori duhet te marre masa qe te jete hartuar bilanci i shoqerise.

c) Asambleja e ortakeve per miratimin e bilancit thirret brenda kater muajve nga mbyllja e vitit financiar dhe per motive shume te veçanta, brenda gjashte muajve.

Neni 31

a) Te ardhurat e realizuara i nenshtrohen te gjitha tatimeve dhe taksave te percaktuara nga ligji shqiptar.

b) Fitimi i nenshtrohet nje shume jo me pak se pese perqind per fond rezerve. Kjo klauzole nuk eshte me e detyrueshme ne rast se perqindja e rezerves arrin ne 10 perqind te kapitalit themeltar.

Neni 32

a) Kontabiliteti mbahet ne shqip sipas ligjeve shqiptare.

b) Humbjet qe rezultojne mbulohen nga fondi rezerve dhe ne rast se ato nuk mjaftojne, nga po keto fonde te destinuara per vitin e ardhshem.

c) Asambleja e ortakeve mund te vendose per forma te tjera te mbulimit te humbjeve.

d) Kur nga humbjet e rezultuara kapitali shoqeror mbetet me pak se kufiri minimal i percaktuar nga ligji, brenda tre muajve, asambleja e ortakeve vendos per mbulimin e tyre dhe per vazhdimesine e shoqerise. Ne rast te kundert, çdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykates duke kerkuar likuidimin e shoqerise.

KREU VIII

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 33

a) Ne rast te mosmarreveshjeve ndermjet ortakeve dhe/ose trashegimtareve te tyre, asambleja e ortakeve do te perpiqet t'i zgjidhe ato me mirekuptim.

b) Ne rast se mirekuptimi nuk arrihet, mosmarreveshje t zgjidhen ne rruge arbitrazhi, sipas neneve 400 e vijues te Kodit Procedure Civile ose ne rruge gjyqesore, duke zbatuar normat proceduriale.

Neni 34

Mosmarreveshjet ndermjet shoqerise dhe te treteve ose ndermjet shoqerise dhe te punesuarve te saj, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen ne rruge gjyqesore sipas ligjit.

KREU IX

PUSHIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISË

Neni 35

a) Shoqeria pushon aktivitetin e saj:

1. kur mbaron afati i percaktuar ne statut.
2. me vendim unanim te asamblese.
3. per shkak te nderprerjes se aktivitetit.
4. me falimentim.
5. me vendim gjyqesor ne rastet e percaktuara nga ligji.
6. ne raste te tjera te percaktuara nga ligji.

b) Pas kesaj asambleja emeron nje ose me shume likuidatore. Ne rast te kundert, eshte gjykata qe emeron likuidatoret dhe percakton perfundimin e likuidimit.

c) Ne perfundim te likuidimit, mbetja qe rezulton i ndahet ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre aktuale ne shoqeri.

Neni 36

Shoqeria nuk pushon aktivitetin e saj, ne rast se ndonjeri nga ortaket vdes, falimenton ose behet i paafte per shkak semundje mendore.

KREU X

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 37

Problemet e punesimit ne shoqeri percaktohen dhe rregullohen sipas legjislacionit te punes, duke lidhur kontratat perkatese.

Neni 38

Ky statut eshte hartuar ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Neni 39

Ne rast te ndryshimeve ne legjislacion, qe per pasoje sjellin qe ky statut te mos perputhet me te, ai do te ndryshohet ne baze te ligjit

ORTAKET PJESEMARRES

KUJTIM BEQJA

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODAJ

DHIMITRI LULEME

ARTAN BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

NOTERE SHPRESA SKRAME

NR.REP. 1013 NR.KOL. 307

VERTETIM

Ne Durres, sot me daten 5.08.99 pese gusht ne Dhomen e Notereve Durres, para meje noteres SHPRESA SKRAME, u paraqiten KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes nr.316818; DHIMITRI LULE i biri i Shomos, dtl.1.07.1964, lindur ne Gjirokaster, banues ne

- - -

Kavaje, identiteti sipas leternjoftimit NF NR.231682; I cili eshte edhe perfaqesues i CHRISTOS SPILIOTOPOULOS , ne baze te prokures nr.1005 rep. e nr.304 Kol. date 2.08.99 te noteres Shpresa Skrame; MILTO HODAJ, i biri i Avniut, dtl.28.12.1962, lindur ne Mallakaster banues ne Ballsh, identiteti sipas(leternjoftimit-prishet nje fjale) pasaportes 1037227 dhe ARTAN BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.27.02.1966 lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes italiane F05046526M, te cilet jane te gjithe me zotesi te plote per te vepruar dhe me deklaruan se nenshkrimet e vena ne kete statut jane te tyre dhe sipas deshires dhe vullnetit te tyre. Une noterja vertetoj, bazuar ne ligjin nr.7829 date 1.06.94.---

N O T E R E

SHPRESA SKRAME

dt 14/06/1996
nr dep ______

" Durres " Dhimitri Bezaitis
1316 7

# K E R K E S E

KERKUESI: 1. Dhimitri Bezaitis, ortak i shoqerise " DURRES "SH.P.K., me seli ne qytetin e Durresit.

2. Fedhon Ioanidhis, ortak i shoqerise " DURRES "SH.P.K., me seli ne qytetin e Durresit.

OBJEKTI: Depozitimi i vendimit Nr.1 date 14.03.1996, te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Te depozitohet vendimi dt 14-6-96
Sekretar Gjykate

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Me vendimin Nr.1 date 14.03.1996, te Asamblese se ortakeve te shoqerise " DURRES "SH.P.K. eshte vendosur largimi nga shoqeria te ortakut Fedhon Ioanidhis, pranimi ne shoqeri te ortakut Sotirios Sotiropullos dhe transferimi 50% te kapitalit te shoqerise nga ortaku Fedhon Ioanidhis qe eshte larguar nga shoqeria te ortaku Sotirios Sotiropullos qe eshte pranuar si ortak ne kete shoqeri.

Lutemi te depozitohet vendimi i Asamblese se ortakeve ne sekretarin e regjistrit tregtar.

Durres, me 14.03.1996.

O R T A K E T

DHIMITRI BEZAITIS      FEDHON IOANIDHIS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr. 6604 Kol.
Nr.________Rep.

V E R T E T I M

Sot me daten 12.6.1996, para meje Sheindie Ledli Notere ne qytetin e Tiranes, u paraqiten Dhimitri Bezaitis, i Kostandinit, i datlindjes 1949, shtetas grek me banim ne Athine te Greqise, me pasaporte Nr.K 420113, dhe Fedhon Ioanidhis, i Nikollaut, i datlindjes 1953, shtetas grek me banim ne Athine te Greqise, te cilet nenshkruan kete kerkese te kartuar prane kesaj zyre dhe une e vertetoj sipas ligjit.

SHOQERIA " DURRES " SH.P.K.

D R R E S

Durres,me 14.03.1996

# V E N D I M Nr. 1

Sot me daten 14.03.1996,u organizua mbledhja e jashtezakonshme e Asamblese se ortakeve te shoqerise " DURRES "SH.P.K.ne te cilen moren pjese te dy ortaket e shoqerise Dhimitri Bezaitis dhe Fedhon Ioanidhis,ne te cilen uvendosa:

1.Largimi nga shoqeria me vullnetin e tij te ortakut Fedhon Ioanidhis

2.Transferimi i kapitalit te shoqerise prej 50% ose 50.000.leke qe i takonte ortakut Fedhon Ioanidhis ortakut te ri qe pranohet ne shoqeri zotit Sotirios Sotiropullos.

3.Pranimi ne shoqeri si ortak i saj te Sotirios Sotiropullos,i biri i Anastasit,i datlindjes 9.4.1948,shtetas grek me banim ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.I 264868.

4.Depozitimin e ketij vendimi ne Sekretarine e regjistrit tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

Ky vendim u muar me unanimitet nga te dy ortaket.

O R T A K E T

DHIMITRI BEZAITIS                FEDHON IOANIDHIS

REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R I A

Nr. 6604 Kol.

Nr.____________Rep.

## V E R T E T I M

Sot me daten 12-6 1996,para meje [signature] Notere ne qytetin e Tiranes,u paraqiten:1.Dhimitri Bezaitis,i Kostandinit,i datlindjes 27.01.1949,shtetas grek me banim ne Athine te Greqise me pasaporte Nr.K 420113 dhe Fedhon Ioanidhis i Nikollaut,shtetas grek me banim ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.K 460472,te dy me zotesi te plote juridike per te vepruar,te cilet neneshkruan kete vendim te Asamblese te hartuar jashte kesaj zyre.

N O T E R E

## KONTRATE SHITJE

E lidhur ne Tirane,sot me daten 14.03.1996,ndermjet:

SHITESIT: Fedhon Nikollau Ioanidhis,shtetas grek,banues ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.K 460472.

BLERESIT: Sotirios Anastas Sotiriopullos,shtetas grek,banues ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.I 264868.

Kontrata lidhet me kushtet si me poshte:

1.Shitesi Fedhon Ioanidhis i shet bleresit Sotirios Sotiropullos 50% qe eshte baraz me 50.000.leke te kapitalit qe ka ne shoqerine " DURRES "SH.P.K. me seli ne qytetin e Durresit me qe eshte larguar nga kjo shoqeri me vendimin e Asamblese se ortakeve te dates 14.03.1996.

2.Bleresi Sotirios Sotiropullos pranon te bleje 50% qe eshte baras me 50.000.leke te kapitalit qe shitesi Fedhon Ioanidhis e ka ne shoqerine "DURRES" SH.P.K.nga e cila eshte larguar dhe ortak i saj eshte bere vete Sotirios Sotiropullos.

3.Te dy palet e kesaj kontrate jane likuiduar sote qe hartohet dhe neneshkruhet kjo kontrate dhe nuk kane asnje pretendim ndaj njeri tjetrit.

Kontrata pasi u lexua dhe u shkrua sipas vullnetit te te dy paleve neneshkruhet prej tyre lirisht dhe pa vrejtje.

| SHITESI | BLERESI |
|---|---|
| Fedhon Ioanidhis | Sotirios Sotiropullos |

REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R I A

Nr. 6605 Kol.

Nr. 2066 Rep.

### V E R T E T I M

Sot me daten 12.6.06 1996,para meje [illegible] Notere ne qytetin e Tiranes,u paraqiten Fedhon Nikollau Ioanidhis,i datlindjes 1953,shtetas grek me banim ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.K 460472 dhe Sotirios Anastas Sotiropullos,i datlindjes 1948,shtetas grek me banim ne Athine te Greqise,me pasaporte Nr.I 264868,te cilet neneshkruan kete kontrate te hartuar jashte kesaj zyre dhe une e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

NR dep. 4053
dt 24/12/1996

13167 R c/1 Floreno Teja
7/08/1996 dt. 20-12-

K E R K E S E

PER NDRYSHIMIN NE STATUT DHE NE AKTIN E THEMELIMIT TE SHOQERISE " DURRES SH.P.K. (ORTAK I VETEM)

GJYKATES RRETHIT

T I R A N E

Ne baze te vendimit nr.13167/1 date 7.08.1996 shoqeria "Durres Sh.P.K. eshte kthyer ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar Ortak i Vetem ku i tille mbetej Sotirios Sotiropullos, qe eshte dhe administratori i shoqerise.

Me vendimin e Ortakut te Vetem date 23.10.1996 eshte njohur si bashkepronar me 40 (Dyzet) % te kuotave ne shoqerine "Durres SH.P.K" z.Kujtim Beqja ; kuota te cilat jane blere me kontraten nr.7140 rep.1954 Kol. date 23.10.1996 nga Kujtim Beqja.

Bazuar ne vendimin e mesiperm te Ortakut te Vetem nr.7141 rep. 1955 kol. date 23.10.1996 paraqiten kerkesa per tu bere ndryshimet perkatese ne Regjistrin Tregtare; ku shoqeria "Durres Sh.P.K" (Ortak i Vetem) kalon ne shoqeri "Durres SH.P.K." me dy ortake, Sotirios Sotiropullos dhe Kujtim Beqja, me kuota kapitali perkatesiht 60 % dhe 40 %. Ne baze te vendimit te mesiperm sejcili nga ortaket ka te drejte te kryeje ne emer dhe per llogari te shoqerise veprime.

Ndryshimet ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit kerkojme te pasqyrohen sipas ligjit ne Regjistrin Tregtar dhe se bashku me kete kerkese ju paraqesim :1.- Vendimin e Ortakut te Vetem nr.7141 kol.1955 rep. date 23.10.1996 ; 2--Kontrate shitje te kuotave nr.7140 rep.1954 kol. date 23.10.1996.

A D M I N I S T R A T O R I

SOTIRIOS SOTIROPULLOS

23. 12. 1996

DURRES SH.p.K.
INDUSTRIAL-COMMERCIAL-CONSTRACTION Co.
PRODHIM BOJRASH
UZINA ELEKTRODAVE SHKOZET
DURRES
TEL./FAX: 0035552/22828

Te depozitohet
sot dt 23 XII 1996

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERISË DURRËS
Nr. Kolek. 7141 Nr. Rep. 1955

Durrës 23.10.1996

## V E N D I M

"PËR NDRYSHIMIN NË STATUT DHE AKTIN E THEMELIMIT" TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, ME ORTAK TË VETËM, SOTIRIOS SOTIROPULLOS, E EMËRTUAR SHOQËRIA "DURRESI SH.P.K).

pronarë, ortak i vetëm
Në datën e sotme, unë Sotirios Sotiropullos, pronarë, ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) DURRESI
dhe administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) DURRESI
me qendër veprimtarie në rrethin Durrës, pas shitjes të 40 (dyzet)
përqind të kuotave të kësaj shoqërie Z. Kujtim Beqja, ku unë Sotirios
Sotiropullos, mbetem me 60 (gjashtëdhjetë) përqind të kuotave, sikurse
përcaktohet në kontratën e shitjes me nr. 7140 Rep. dhe 1954 Kolek.
dt. 23.10.1996, të hartuar në zyrën e noterisë Durrës

## V E N D O S A

23.12.1996

- Të njoh bashkëpronarë në masën 40 (dyzet) përqind të kuotave në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Durrësi" SH.P.K, Z. Kujtim Beqja.
- Unë Sotirios Sotiropullos mbetem bashkëpronarë në shoqërinë e mësipërme në masën 60 (gjashtëdhjetë) përqind të kuotave, të kësaj shoqërie dhe bashkëpronarë në këtë masë me Z. Kujtim Beqja, i cili ka 40 (dyzet) përqind të kuotave.
- Të bëhen ndryshimet e mësipërme në statutin e shoqërisë ~~xxxxxxxxxx~~ dhe në aktin e themelimit të saj duke përcaktuar se bashkëpronarë dhe ortakë të vetëm të shoqërisë do të jenë se personat Sotirios Sotiropullos dhe Kujtim Beqja në masën e kuotave të mësipërme.
- Secili ka të drejtë të kryej veprime në emër dhe për llogari të shoqërisë pra, si unë Sotirios ashtu edhe Kujtimi, duke i konsideruar veprimet e kryera nga secili si të vlefshme.

ORTAKU I VETËM
(SOTIRIOS SOTIROPULLOS)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 15181 Dt 23.12.1996
Vertetohet kjesia me Origjinalin

PULLE TAKSE
20 LEKE
E SHQIPERISE

## V E R T E T I M

Sot në datën njëzet e tre tetor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë para meje noteres Lula, u paraqit Z. Sotirios Sotiropullos
…OMPRESA SHAHIU… të veprosh, identitetin e të cilit e verifikova
… i tij personalisht, i cili në praninë time nënshkroi këtë
vendim të nxjerrë prej tij, për ndryshime në statut dhe aktin e themelimit të shoqërisë "DURRESI" SH.P.K. Unë noterja vërtetoj..............

NOTERE (LINDITA LULA)

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERISË DURRES
Nr.Rep. 7/40 Nr.Kolek. 1954

Durrës 23.10.1996

23.12.1996

KONTRATË SHITJE

Sot në datën 23.10.1996, para meje noteres, LINDITA LULA, notere pranë dhomës noterisë Durrës, u paraqitën personalisht:

1.SOTIRIOS SOTIROPULLOS, i biri Anastasios dhe Gjeorgjies, i dl.9.4. 1948 , banues në rrugën Oropu Nr.5 Ekali ,Athinë të Greqisë, me zotësi të plotë për të vepruar, identitetin e të cilit e verifikova me pasaportën e tij personale,me cilësinë e shitësit:

2. KUJTIM BEQJA, i biri Iljazit dhe Nepit , i dl.7.11.1957, banues në lagjen nr.4 Rruga" Asim Vokshi"Nr.32, Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, identitetin e të cilit e verifikova me letërnjoftimin e tij personal, me cilësinë e blerësit:

Palët deklaruan se lidhin këtë kontratë ku Sotirios paraqitet me cilësinë e shitësit dhe Kujtimi me cilësinë e blerësit të kuotave.

Sotirios Sotiropullos është pronarë dhe ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) Durrës, ku ka 100 përqind të kuotave të saj, e cila e ka qendrën e veprimtarisë në Shkozet Durrës.Kjo shoqëri me ortak të vetëm,pronarë dhe administratorë Z. Sotirios Sotiropullos, është miratuar përfundimisht me vendimin e gjykatës rrethit Tiranë me nr.13167/1 dt.7.8.1996 .

Z. Sotirios Sotiropullos në këtë shoqëri bën bashkëortak duke i shitur Kujtim Beqjes 40(dyzet)përqind të kuotave të tij, në vleftën prej 1.000. 000(një miljon lekë).

Z.Sotirios Sotiropullos deklaroi se shumën prej një miljon lekë të shitjes të 40 përqind të kuotave e ka marrë dorazi nga blerësi Kujtim Beqja ,jasht kësaj zyre dhe nga ky moment e njeh atë bashkëortak në masën 40 (dyzet) përqind të kuotave ,në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) Durrës.

Z.Kujtim Beqja deklaroi se ka blerë 40(dyzet )përqind të kuotave dhe se është bërë bashkëortak në këtë shoqëri.

Nga ky moment shoqëria do të jetë me dy ortakë dhe konkretisht, nga Z. Sotirios Sotiropullos dhe nga Z.Kujtim Beqja, duke patur secili bashkë-pronësi në këtë shoqëri në masën 60(gjashtëdhjetë ) përqind Z.Sotirios Sotiropullos dhe 40(dyzet) përqind të kuotave Kujtim Beqja.

Z. Sotirios Sotiropullos, nga ky moment i jep të drejtën Z.Kujtim Beqja, si bashkëpronarë në masën 40(dyzet ) përqind të kuotave, të kryej veprim në emër dhe për llogari të shoqërisë, duke e përfaqësuar shoqërinë, para të gjithë organeve shtetërore, gjyqësore dhe para shoqërive dhe persona fizik privat, për të kryer çdo lloj veprimi në emër dhe për llogari të

shoqërisë duke i konsideruar veprimet e kryera nga bashkëortaku Kujtim
të vlefshme, që sjellin detyrime dhe të drejta për shoqërinë.
Për çdo veprim që kryhet nga secili ortak në emër dhe për llogeri të
shoqërisë konsiderohet nga ortakët i vlefshëm.
Në bazë të kësaj kontrate, nga kjo datë do të behen ndryshimet edhe në
statut dhe në aktin e themelimit, duke qenë të dy bashkëpronarë të kësaj
shoqërie në kuotat në masën 60(gjashtëdhjetë) përqind Sotirios Sotiropu-
llos dhe 40(dyzet) përqind Kujtim Beqja.
Kjo kontratë pasi u lexua, në praninë time, noteres LINDITA LULA,
dhe u gjend konformë vullnetit të palëve, nënshkruhet prej tyre.

SHITESI

( SOTIRIOS SOTIROPULLOS)

BLERESI

(KUJTIM BEQJA )

NOTERE

( LINDITA LULA )

23. 12. 1996

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERAVE TIRANE
Nr Rep ... Dt 23/12 1996
Vertetohet Njesia me Origjinalin

NOTERE
SHPRESA SPAHIU

13167
22/12/1995

REPUBLIKA E SHQIPERISE

"Durres" 
Dhimiter Bezaitis

Tirane me 7.08.1996

NR 2731
dt 8/08/1996

KERKESE DREJTUAR GJYKATES SE RRETHIT TIRANE PER LARGIM ORTAKU.

KERKUES: SOTIRIOS SOTIROPULLOS, lindur me vitin 1948, shtetas grek me banim te perkohshme ne shqiperi, me nr. pasaporte: I 2[illegible]68.

OBJEKTI: Largim i njerit ortak nga shoqeria "Durres"-SHPK, pasqyrimi i ndryshimeve ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane, sipas ligjit Nr.7638 dhe Nr.7667.

PER KOMPETENCE GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Une Sotirios Sotiropullos ortak i shoqerise "Durres-SHPK" se bashku me Dhimitri Bezaitis kemi krijuar nje shoqeri ku zoterojme secili nga 50 % te kuotave te kapitalit.

Me kerkesen drejtuar shoqerise ortaku Dhimiter Bezaitis per tu larguar, shoqeria me vendimin e ortakeve Nr.1 date 02.08.1996 merr vendim dhe largon ortakun Dhimiter Bezaitis duke mos patur keshtu ky ortak qe largohet asnje te drejte dhe detyrim ndaj kesaj shoqerie dhe ndaj te treteve.

Po keshtu me kontraten dt.02.08.1996 me Nr. rep.3908 dhe Nr.Kol. 3094 ortaku Dhimiter Bezaitis, i shet pjesen e tij te kuotave te kapitalit ortakut tjeter te shoqerise i cili behet keshtu zoterues i vetem i kuotave te kapitalit dhe ortak i vetem i saj.

Me kete kerkese drejtuar Gjykates ortaku i vetem i shoqerise Sotirios Sotiropullos kerkon qe keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin tregtar te Gjykates duke bere shenimet perkatese.

KERKUES

ORTAKU I VETEM SOTIRIOS SOTIROPULLOS

Sotirios Sotiropoulos

SHOQERIA "DURRES sh.p.k."

D U R R E S

# V E N D I M

## Nr.1 date 02.08.1996

Sot me daten 02.08.1996 ne qendron e Shoqerise "DURRES sh. p.k." u be mbledhja e jashtezakonshme e asamblese se ortakeve, ku moren pjese te gjithe ortaket e kesaj shoqerie dhe konkretisht:

Dhimitris Bezaitis dhe Sotirios Sotiropullos te dy ortak me pjesemarrje te barabart ne kapitalin e shoqerise nga 50% secili.

Ne kete mbledhje me unanimitet votash te dy ortakeve u vendos qe te behen disa ndryshime ne shoqeri dhe ne statutin e saj dhe konkretis

1)DHIMITRI BEZAITIS me deshiren e tij dhe me pelqimin edhe te ortakut tjeter largohet nga kjo shoqeri, duke ja shitur kuotat e kapitalit qe zoteron ne kete shoqeri, ortakut tjeter Sotiris Sotiropullos.

2)Sotirios Sotiropullos eshte dakord qe te bleje kuotat e kapitalit qe zoteron Dhimitris Bezaitis, te cilat per qesojne 50.000 (pesedhjete mije) leke baraz me 50 % te kapitalit te shoqerise.

3)Shoqeria "DURRES sh.p.k." me qender ne Durres do te vazhdoje te kryej aktivitetin e saj me ortak te vetem SOTIRIOS SOTIROPULLOS i cili do te jete pronar i vetem dhe administrator i kesaj shoqerie nga data e kesaj mbledhje e ne vazhdim.

4)Ky vendim i marre me unanimetin e votave te dy ortakeve ti dergohet per te bere veprimet perkatese ne regjistrin tregetar prane Gjykates ne Tiranes.

O R T A K E T

(DHIMITRIS BEZAITIS) (SOTIRIOS SOTIROPULLOS)

<u>K O N T R A T E</u>

Sot me daten 02.08.1996 ne Durres,para meje avokatit **JANI LEZO** me qender ne Durres u paraqiten:

1.DHIMITRIS BEZAITIS i datelindjes 1949 shtetas grek me banim te perkohshem ne Shqiperi me pasaport Nr.K.420113.

2.SOTIRIOS SOTIROPULLOS i datelindjes 1948 shtetas grek me banim te perkohshem ne Shqiperi,me pasaport Nr.I 264868.

te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si me poshte:

Ne baze te vendimit Nr.1 date 02.08.1996 te asamblese se ortakeve te shoqerise "DURRES sh.p.k." Dhimitris Bezaitis largohet nga shoqeria ne jale dhe kuotat qe zoteronte ne kete shoqeri prej 50% te kapitalit te saj qe per aqesojne 50.000 (pesedhjete mije) leke ,me kete vle te ja shete zotit SOTIRIOS SOTIROPULLOS qe mbetet ortak i vetem ne kete shoqeri.Me largimin e tij nga shoqeria ai nuk ka me asnje pretendim ndaj shoqerise dhe asnje detyrim ndaj saj.

Sotirios Sotiropullos deklaron se pranon e erten e Z.Dhimitris Bezaitis dhe blene kuotat e tij qe per aqesojne 50% te kapitalit te Shoqerise "DURRES sh.p.k." te vleresuara ne 50.000 (pesedhjete mije) lek

Me kete kontrate te dy palet deklaruan se nuk kane asnje pretendim ndaj njeri tjetrit dhe e konsiderojne vetn te shlyer plotesisht.

Kjo kontrate u redaktua ne tre kopje dhe pasi u lexua dhe u pranua iremoset pa kundershtim.

DHIMITRIS BEZAITIS

SOTIRIOS SOTIROPULLOS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
Nr.rep. 3908 Nr.kolek. 3094

REPUBLIKA E SHQIPERISE BUJAR TROCI NOTER DURRES

<u>V E R T E T I M</u>

SOT ME DATEN 02.08.1996 ne Durres para meje Bujar Troci noter me qender ne Durres u paraqiten personalisht:DHIMITRIS BEZAITIS i datelindjes 1949,shtetas grek me pasaport Nr.K.420113 dhe SOTIRIOS SOTIROPULLOS i datelindjes 1948 shtetas grem me pasaport Nr.I 264868,te cilet n

Dep 5115 elt. 15.04.98. Z. M. [illegible]
13162/[illegible] 15.4.1998

KERKESE

**KERKUESI:** KUJTIM ILJAZ BEQJA, dtl.1957 lindur dhe banues ne Tirane rr"Asim Vokshi"; Ortak i Vetem dhe Administrator i Shoqerise " DORIAN " SH.P.K.

**OBJEKTI:** Depozitimi ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit nr.04 date 10.04.1998 te Ortakut te Vetem; te ndryshimit te emrit te shoqerise nga "DURRESI " SH.P.K. ne "DORIAN " SH.P.K.

Baza ligjore neni 33 i Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregtar".

PERPARA

GJYKATES RRETHIT

TIRANE

Sipas vendimit nr.13167 date 22.12.1995 eshte rregjistruar shoqeria " DURRESI " SH.P.K.; si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar; ne Rregjistrin Tregtar.Kjo shoqeri tashme sipas vendimit nr.13167/2 date 18.11.1997 eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , Ortak i Vetem; me administrator KUJTIM BEQJA; i cili eshte dhe Ortaku i Vetem.

Me vendimin nr.04 date 10.04.1998 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ndryshimi i emrit te shoqerise nga " DURRESI" SH.P.K. ne "DORIAN" SH.P.K. dhe ky ndryshim duhet te depozitohet sipas ligjit ne Rregjistrin Tregtar dhe per kete aresye paraqesim kete kerkese.

Bashkelidhur me kete kerkese paraqesim vendimin nr.04 date 10.04.1998 te Ortakut te Vetem.

ADMINISTRATOR
( ORTAKU I VETEM )
KUJTIM BEQJA

DURRES Shpk Bajra DORIAN DURRES ALBANIA

## V E N D I M Nr.4

## I ORTAKUT TE VETEM

Sot, me date 10.04.1998, ne qytetin e Durresit; une, Kujtim Beqja Ortak i Vetem dhe administrator i shoqerise " DURRESI " SH.P.K.; i rregjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane;

**V E N D O S A :**

1.- Ndryshimin e emrit te Shoqerise nga "DURRESI" SH. P.K. ne "DORIAN " SH.P.K.

2.- Te behet kerkesa per depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te ndryshimit te mesiperm te emrit te shoqerise.

O R T A K U I V E T E M

KUJTIM BEQJA

DURRES Shpk DORIAN DURRES ALBANIA

13167

K E R K E S E

PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

KERKUESIT: DHIMITRI BEZAITIS i biri i Kostandinit i datelindjes 27.I.1949 shtetas grek me banim provizor ne Durres me pasaport Nr.K 420113.

FEDHON IOANIDHIS i biri i Nikollaut i datelindjes 29.03.1953 me banim ne Athine te Greqise me pashport Nr.K 460472.

OBJEKTI I KERKESES

Kerkohet regjistrimi si person juridik shoqeria me pergje- gjesi te kufizuar "DURRES sh.p.k." me qender ne Durres, ne baze te nenit 37 e vijues te Ligjit Nr.7667 date 28.I. 1993.

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Te dy neve kerkuesit me vullnet te plote, ne baze te aktit te themelimit date 15 Dhjetor 1995 krijuar shoqerine me pergjegjesi te ku- fizuar "DURRES sh.p.k." Kjo shoqeri ka si ortak themelues Dhimitri Bezai- tis dhe Fedhon Ioanidhis, me qender ne Durres le gajen Nr.14 ne terito- e Uzines se Elektrodave dhe me kapital themelues 100.000 leke, te for- muar dhe nenshkruar nga te dy ortaket me kontribut te barabarte nga 50 perqinde secili. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per 15 vjet dhe me objekt te veprimtarise se saj: Prodhimin dhe tregetimin e bojrave te ndryshme, si dhe te materialeve te tjera te ndertimit. Pro- dhimin dhe tregetimin ne forme import eksporti te parafabrikateve te ndryshme dhe te pajisjeve per sektorin e ndertimit te banesave, objekte te karakterit industrial dhe shoqeror. Ushtrimin e tregetise ne forme import eksporti, me shumice e me pakice te mallrave nga te gjitha llojet pa kufizim, si te mallrave industriale, makineri e pajisje, pjese kembimi per industrine dhe automjetet, aparatura elektroshtepijake, artikuj ushq- more te çdo lloji, prodhime bujqesore e blegtorale, prodhime farmaceutik per njerezit, kafshet dhe bimet, si dhe te lidh marreveshje perfaqesimi per marrjen e kredive nga bankat e K.E.

Per provimin e pretendimeve tona bashkelidhur ju paraqesim nje kopje te aktit te themelimit te firmosur nga neve dhe te noterizu- nje kopje te statutit per funksionimin e shoqerise dhe vertetimin per depozitimin e kapitalit.

Duke pretenduar se dokumentacioni per krijimin e kesaj shoq- rie eshte i plote dhe koforme kerkesave te ligjit, lutemi qe te bene regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar, me qellim qe te fitoje perso- litetin juridik dhe te filloj nga aktiviteti.

K E R K U E S I T

(Dhimitri Bezaitis) (Fedhon Ioanidhis)

Vend 13167/6

A V O K A T E
SHPRESA SKRAME
D U R R E S

SHOQERIA "DORIAN"SH.P.K.

D U R R E S

# K E R K E S E

e

KERKUESIT : KUJTIM BEQJA, ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "DORIAN"SH.P.K.

ME OBJEKT : Kerkoj depozitimin e vendimit te ortakut te vetem per transferim kuotash dhe shtim ortakesh, ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993.

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Z.Kryetar

Ju parashtroj se jam ortak i vetem dhe administrator i shoqerise tregetare "DORIAN"sh.p.k. e njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane.

Me vendimin nr.5 date 23.09.1998 kam vendosur pranimin ne kete shoqeri te zz.DHIMITRI LUMEME, MILTO HODAJ, ARTAN BEQJA dhe KRISTO SPILOTOPULLOS dhe te transferoj ne favor te tyre respektivisht 23%, 23%, 23% dhe 5% te kuotave, duke mbajtur per vete 26% te kuotave. Per kete eshte hartuar edhe kontrata perkatese e shitblerjes se kuotave.

Kerkoj depozitimin e ketij vendimi ne Skeden perkatese te Regjistrit tregetar prane asaj gjykate.

Bashkelidhur:

- Vendimin nr.5 date 23.09.1998 te ortakut te vetem.
- Kontraten e shitblerjes se kuotave.
- Nje kopje vendimi regjistrimi.

K E R K U E S I

KUJTIM BEQJA

Kontrata noterale Nr. 2925/1575 dt. 24-09-98 noter.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

NR.REP 7924 NR.KOL 1574

V E R T E T I M

Sot,me daten 24.09.1998 (njezetekater shtator nentedhjetetete) ne dhomen e notereve Durres u paraqit KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit, dtl. 7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "DORIAN"SH.P.K. identitetin e te cilit e vertetova me ane te patentes nr.316818 leshuar ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, i cili para meje nenshkroi kete kerkese. Une noteri vertetoj.----

N O T E R I

NAZMI CANKJA

A V O K A T E
SHPRESA SKRAME
D U R R E S

SHOQERIA TREGETARE

"DORIAN" SH.P.K.

D U R R E S

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

E lidhur ndermjet paleve kontraktuese:

SHITESI : KUJTIM BEQJA, i biri i Oljazit, dtl.7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, ortak i vetem i shoqerise "DORIAN"sh.p.k, shtetas shqiptar.

BLERESAT : DHIMITRI LULEME, i biri i Shomos, lindur ne Gjirokaster, banues ne Kavaje, dtl.1.07.1964, shtetas shqiptar.

MILTO HODAJ, i biri i Avniut, dtl.28.12.1952,lindur ne Mallakaster, banues ne Ballsh, shtetas shqiptar.

ARTAN BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane. shtetas shqiptar.

KRISTO SPILOTOPULLOS, i biri i Nikos, dtl.1940, lindur dhe banues ne Athine, Greqi, shtetas grek.

Shoqeria "DORIAN"shpk me qender ne Durres, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane. Kuotat e kapitalit prej 100.000 lek zoterohen ne masen 100% nga ortaku i vetem Kujtim Beqja. Me vendim te ketij te fundit dhe sipas kerkeses se bleresave, ai i transferon me ane te shitjes keto kuota si me poshte vijon: ne favor te z. Dhimitri Luleme 23%, ne favor te z.Milto Hodaj 23%, ne favor te z.Artan Beqja 23% dhe ne favor te z.Kristo Spilotopullos 5% te kuotave, duke mbetur ne pronesi te tij 26 % e kuotave.

Blresit kane kryer likuidimin e vleftes se ketyre kuotave respektivisht 23.000 leke, 23.000 leke, 23.000 leke dhe 5.000 leke.

Ne kete menyre ka kaluar pronesia dhe eshte kryer transferimi i ketyre kuotave ne raportet e mesiperme, nga shitesi Kujtim Beqja, i cili çvishet nga pronesia tek bleresit.

Per sa me siper palet e lexojne dhe pasi konstatojne se eshte ne perputhje te plote me deshiren dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne me firmat e tyre. SHITESI(KUJTIM BEQJA) BLERESIT(DHIMITRI LULEME)

MILTO HODAJ ARTAN BEQJA KRISTO SPILOTOPULLOS

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

NR.REP. 2925 NR.KOL. 1575

V E R T E T I M

Sot,me daten 24.09.1998 (njezetekater shtator nentedhjetetete)ne dhomen e notereve Durres, para meje noterit NAZMI CANKJA, u paraqiten palet e kontrates se shitblerjes, shitesi KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit, dtl. 7.11.1957,lindur dhe banues ne Tirane,identitetin e te cilit e verifikova me ane te patentes NR.316818; dhe bleresat: 1) DHIMITRI LULEME, i biri i Shomos, dtl.1.07.1964, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Kavaje,identitetin e te cilit e vertetova me ane te leternjoftimit NF N.231682; MILTO HODAJ, i biri i Avniut, dtl.28.12.1962,lindur ne Mallakaster, banues ne Ballsh, identiteti sipas pasaportes nr.1037227; ARTAN BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes italiane F05046526M dhe KRISTO SPILOTOPULLOS, i biri i Nikos, dtl.1940, shtetas grek, lindur ne Athine dhe banues po aty, identiteti sipas pasaportes L 350855, te cilet para meje nenshkruan kete kontrate shitblerje kuotash. Une noteri vertetoj.------

N O T E R I

NAZMI CANKJA

AVOKATE
SHPRESA SKRAME
DURRES

SHOQERIA TREGETARE

"DORIAN" SH.P.K.

D U R R E S

V E N D I M

NR. 05 DATE 23.09.1998

I ORTAKUT TE VETEM

Sot,me daten 23.09.1998, une Kujtim Beqja, ortak i vetem i shoqerise "DORIAN"sh.p.k., me qender ne Durres, e njohur dhe e regjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim aktivitetin e kesaj shoqerie dhe kerkesat e zz. Dhimitri Luleme, Milto Hodaj, Artan Beqja dhe Kristo Spilotopullos, te cilet kerkojne te marrin pjese si ortake ne kete shoqeri dhe

K O N S T A T O V A

Shoqeria "DORIAN" eshte regjistruar ne Regjistrin Tregetar me ane tevendimit nr. 13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane dhe ushrton aktivitetin e saj sipas liçences perkatese me qender ne Durres, duke patur si ortak te vetem Kujtim Beqja.

Zoterinje Dhimitri Luleme, Milto Hodaj, Artan Beqja dhe Kristo Spilotopullos, kane kerkuar te marrin pjese ne kete shoqeri si ortake, duke blere perkatesisht 23%, 23%, 23% dhe 5% te kuotave te kapitalit dhe duke ju nenshtruar te gjitha detyrimeve qe krijon kjo ortakeri.

Duke marre parasysh mbarevajtjen e shoqerise si dhe personalitetin dhe mundesite ekonomike te kerkuesve,

V E N D O S A

1. Te pranoj kerkesen e zz.Dhimitri Luleme, Milto Hodaj, Artan Beqja dhe Kristo Spilotopullos per te marre pjese si ortake ne shoqerine "DORIAN"sh.p.k.

2. Te transferoje me ane te shitjes ne favor te tyre respektivisht 23%, 23%, 23% dhe 5% te kuotave te kapitalit, duke mbetur une vete me 26 % te kuotave te kapitalit.

3. Te kryhen veprimet dhe te hartohet kontrata e shitblerjes se kuotave te kapitalit.

4. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne GJykaten e Rrethit TIrane per te kryer depozitimin ne Regjistrin Tregetar.

5.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKU I VETEM

KUJTIM BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

NR.REP. 2923 NR.KOL. 1573

VERTETIM

Sot,me daten 24.09.1998 (njezetekater shtator nentedhjetetete) ne Dhomen e Notereve Durres, para meje noterit NAZMI CANKJA, u paraqit KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar,identitetin e te cilit e vertetova me ane te patentes nr.316818, leshuar ne Tirane, i cili me deklaroi se firma e vene ne kete akt eshte e tij dhe e vene me deshire te plote e vullnet te lire. Une noteri vertetoj.------

NOTERI

NAZMI CANKJA

13167/7
7319

REPUBLIKA E SHQIPERISE SHPRESA SKRAME NOTERE DURRES

# K E R K E S E

e

K E R K U E S I T : KUJTIM BEQJA , i biri i Iljazit, dtl.7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, administrator i shoqerise DORIAN shpk me qender ne Durres.

ME OBJEKT: Kerkoj depozitimin e vendimit nr.6 date 4.08.99 te Asamblese se ortakeve si dhe Statutit te ndryshuar te shoqerise " DORIAN"sh.p.k. ne baze to ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjist in Tregetar".

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Shoqeria DORIAN sh.p.k. eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.95 te Gjykates se rrethit Tirane, dhe me pas jane bere ndryshime te tjera.

Sot ajo perbehet nga 5 ortake, te cilet kane vendosur qe te kene nje numer te barabarta kuotash ndermjet tyre, gje qe pasqyrohet ne vendimin nr.6 date 4.08.99 te Asamblese se Ortakeve dh ne kontraten e shitblerjes se kuotave.

Veç kesaj duke qene se fillimisht shoqeria ka qene me ortak te vetem, statuti i depozituar ne Regjistrin Tregetar nuk i pershtatet gjendjes me 5 ortake, prandaj eshte hartuar, ne perputhje me ligjin Statuti i ndryshuar.

Kerkojme depozitimin e ketyre akteve ne Skeden Sharkate te Regjistrit Tregetar prane asaj Gjykate.

Bashkelidhur:

- Statuti i ndryshuar.
- Vendimi nr.6 date 4.08.99 i Asamblese se Ortakeve.
- Kontrata e Shitblerjes se kuotave.

K E R K U E S I

KUJTIM BEQJA

Kujtim Beqja

Te depozitohet vendimi i ... dt. 08-11-1999

Kontrate shitblerje nr. 1013 / 30 shtator ... i Noteres ...

Gjyqtare M. Dedi

SHOQERIA DORIAN SH.P.K.

DURRES

# VENDIM

## N. 6 DATE 4.08.99

## I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve e shoqerise "DORIAN"sh.p.k. ne Durres e perbere nga ortaket Kujtim Beqja, Milto Hodaj, Dhimitri Luleme, Artan Beqja dhe Christos Spiliotopoulos(perfaqesuar nga Dhimitri Luleme) , mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe:

## KONSTATOI SE:

Shoqeria "DORIAN"sh.p.k., e regjistruar ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa ndryshime te metejshme dhe aktualisht ortaket zoterojne kuotat si me poshte:

Kujtim Beqja 26%, Dhimitri Luleme 23%, Milto Hodaj 23%, Artan Beqja 23 % dhe Christos Spiliotopoulos 5% te kuotave. Ortaket mendojne qe ne kete shoqeri te gjithe te zoterojne nje numer te barabarte kuotash, pra nga 20%secili.

Veç kesaj duke qene se fillimisht shoqeria eshte krijuar me ortak te vetem dhe ndryshimet e metejshme te saj kane sjelle qe statuti i depozituar te mos perputhet plotesisht me kushtet aktuale ne te cilat ndodhet shoqeria, ortaket mendojne qe te hartohet statuti i ndryshuar, i cili te depozitohet ne Regjistrin Tregetar ne Skeden perkatese te shoqerise, se bashku me dokumentat e tjera.

## PER KETO ARESYE

Asambleja e ortakeve e shoqerise "DORIAN"sh.p.k. bazuar ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare",

## VENDOSI

1. Te miratoje transferimin e kuotave me ane te shitjes ndermjet ortakeve, ne menyre qe te gjithe ortaket te kene nga 20% te tyre.

- - -

2. Te kryhen veprimet e te hartohet kontrata e shitblerjes se kuotave ndermjet ortakeve.

3. Te hartohet Statuti( i ndryshuar) i shoqerise.

4. Te dergohen per depozitim ne Regjistrin Tregetar ky vendim dhe Statuti ( i ndryshuar).

5. Ne statut te pasqyrohet ne perputhje me ligjin, gjendja aktuale e shoqerise.

6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

KUJTIM BEQJA

MILTO HODAJ

DHIMITRI LULEME

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

ARTAN BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1013 NR.KOL. 307

VERTETIM

Ne Durres, sot me 5.08.99 pese gusht nentedhjetenente para meje noteres SHPRESA SKRAME, ne Dhomen e Notereve Durres, u paraqiten KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit,dtl.7.11.1957,lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes nr.316818; DHIMITRI LULEME, i biri i Shomos, dtl.1.07.1964, lindur ne Gjirokaster, banues ne Kavaje, identiteti sipas leternjoftimit NF 231682, i cili eshte edhe perfaqesues i CHRISTOS SPILIOTOPOULOS, sipas prokure 1005/304 date 2.08.99 te noteres Shpresa Skrame; MILTO HODAJ, i biri i Avniut, dtl.28.12.1962,lindur ne Mallakaster, banues ne Ballsh, identiteti sipas pasaportes 1037227 dhe ARTAN BEQJA, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.66,lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes italian F05046526M,qe nenshkruan kete vendim.Une noterja vertetoj.---

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1013 NR.KOL. 307

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Durres sot me daten 5.08.99 pese gusht para meje noteres SHPRESA SKRAME, ne Dhomen e Notereve Durres u paraqiten personalisht palet: ----

SHITESAT: ----

1. KUJTIM BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes nr.316818, qe zoteron 26 % te kuotave.
2. DHIMITRI LULEME, i biri i Shomos, dtl.1.07.1964, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Kavaje, identiteti sipas Leternjoftimit NF 231682, me 23 % te kuotave.
3. MILTO HODO, i biri i Avniut, dtl.28.12.1962, lindur ne Mallakaster dhe banues ne Ballsh, identitetis sipas pasaportes numer 1037227, me 23 % te kuotave.
4. ARTAN BEQJA, i biri iIljazit, dtl.27.02.66; lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas patentes italiane F05046526M, me 23% te kuotave.

BLERESI : CHRISTOS SPILIOTOPOULOS, qe zoteron 5% te kuotave, i perfaqesuar nga Dhimitri Luleme sipas prokure nr.1005/304 date 2.08.99 te noteres Shpresa Skrame, ne Durres.

Te gjithe jane ortake pjesemarres te shoqerise "DORIAN"sh.p.k. Durres, e njohur dhe regjistruar me vendimin nr.13167 date 22.12.95 te Gjykates se rrethit Tirane dhe te gjithe jane me zotesi te plote per te vepruar. ---

Shitesi Kujtim Beqja i shet bleresit Christos Spiliotopoulos 6(gjashte) % te kuotave qe zoteron, ne vleften 6000 leke.

Shitesit Dhimitri Luleme, Milto Hodo dhe Artan Beqja i shesin bleresit Christos Spiliotopoulos secili nga 3(tre) % te kuotave respektive me vlefte nga 3000 secili.

Ne kete menyre shitesat mbeten me nga 20% te kuotave secili dhe po 20% t kuotave i behen bleresit.

Shitesit deklarojne se jane likuiduar jashte zyres notoria per vleftat perkatese te kuotave te shitura dhe nuk kane asnje ppretendim ndaj bler sit. Po keshtu edhe bleresi deklaron se nuk ka asnje pretendim ndaj tyre. ——

Ne kete menyre kalon pronesia mbi kuotat e percaktuara me lart nga shitesat tek bleresi, duke u bere te gjithe ortaket me nga 20%(njezet) te kuotave ne shoqerine "DORIAN"sh.p.k. me nga nje vlefte prej 20.000 (njezetmijo)leke.——

Per sa me siper u lexua, pranohet nga palet dhe nenshkruhet nga ata para meje, pasi u gjet ne perputhje te plote me deshiren dhe vullnetin e tyre.——

Une, noterja, bazuar ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjin nr.7829 date 1.06.94 vertetoj.——

P A L E T

SHITESAT

KUJTIM BEQJA

DHIMITRI LULEME

MILTO HODO

ARTAN BEQJA

BLERESI

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS(perfaqesuar nga Dh.Luleme

N O T E R E

SHPRESA SKRAME

13167/B 3 B Mucaj 05 07 2004

Taksa u Likuidua NOTERE Shpresa SKRAME

05 KORRIK 2004

KERKESE

KERKUESI : Kujtim BEQJA, i biri i Iljazit, dtl.07.11.1957, banues ne Tirane, administrator i shoqerise "DORIAN" shpk,me seli ne Durres.

OBJEKTI : Depozitimi i Vendimit nr.7 date 3.06.2004 dhe nr.8 date 16.06.2004 te Asamblese se Ortakeve.

BAZA LIGJORE : Neni 20 i Ligjit nr.7632 dt.4.11.1992 "Per pjesen e pare Te Kodit Tregetar", neni 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe neni 33 i Ligjit 7667 date 23.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar".

***GJYKATES SE RRETHIT***

***TIRANE***

Z.Kryetar.

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres dhe aktivitet ne fushen e tregetise dhe ne fusha te tjera, me kapital themeltar 100.000 leke dhe me administrator Kujtim Beqja, është njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te kapitalit dhe aktualisht, perbehet nga pese ortake Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Dhimitri Luleme, Milto Hodaj dhe Artan Beqja me nga 20% te kuotave te kapitalit secili.

Me vendimin nr.7 date 3.06.2004 te Asamblese se Ortakeve, është vendosur :

1. Te pranohet largimi i ortakut Dhimitri Luleme nga pjesemarrja ne shoqerine DORIAN shpk.
2. Te miratohet shitblerja e 20% te kuotave nga ortaku Dhimitri Luleme qe largohet tek kater ortaket qe mbeten, Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodaj dhe Artan Beqja, ne menyre te barabarte nga 5% secili, duke u bere keshtu secili prej tyre me nga 25% te kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri.

Ndersa me vendimin nr.8 date 16.06.2004 është vendosur:

1. Te emeroje zj.***Nadire Hyseni si eksperte kontabel*** per te kryer vleresimet dhe procedurat e shtimit te kapitalit te shoqerise.

Duke qene se plotesohen kushtet qe kerkohen nga Ligji per "Regjistrin Tregetar", dhe Statuti i Shoqerise, kerkoj depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve ne Skeden perkatese te regjistrimit.

Bashkelidhur një kopje vendimi dhe kontrate.

KERKUESI
KUJTIM BEQJA

Kontrate shitblerje Nr 5751/14 dt 3.6.04
Vendim Nr 7 dt 3.6.04
Vendim Nr 8 dt 16.6.04 As Ortakeve
Vendim Nr 43 dt 10.1.2000

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE (IEKA)



# LICENSE

*Kjo license i leshohet ,* NADIRE SULEJMAN HYSENI

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR .**

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin:* 43 *, sipas kesaj liste.*

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

Berberi

*Leshuar me,* 10. 02. 2000

1 3167/87 A Caro
11 11 2004

PULLE TAKSE
100 LEKE

**REUBLIKA E SHQIPERISE**
**Shoqeria "DORJAN" Sh.p.k.**
**DURRES**

# KERKESE

**Kerkuesi :** Administratori i shoqerise "**DORJAN**" Sh.p.k. – Durres, Kujtim **BEQJA**, banues ne Durres

**Objekti :** *Depozitim prane Rregjistrit Tregetar te Gjykates rrethit – TIRANE, te vendimit te Asamblese Jashtezakoneshme te Ortakeve te Shoqerise "**DORJAN**" Sh.p.k. Durres.*
*Per zmadhim Kapitali Themeltar nga **100.000** leke, ne **5.000.000** leke*

**Gjykates te Rrethit,**
**TIRANE**

Me vendimin Nr. 13167/8, date 08.07.2004, eshte rregjistruar si Person Juridik, Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "**DORJAN**", me 4 (kater) ortake., me kapital themeltar 100.000 leke

Sipas vendimit Nr. 8, date 16.04.2004 te Asamblese se Jashtezakoneshme te Ortakeve te kesaj Shoqerie, eshte vendosur te kryhet Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te Shoqerise, per **4.900.000** leke. Pas ketij veprimi, Kapitali Themeltar i Shoqerise "**DORJAN**" sh.p.k. behet **5.000.000** leke.
Perberja e tij mbetet si me posht:

1. Z. Kujtim BEQJA, do te zoteroje **25%** te Kapitalit Shoqeror,
2. Z. Christos SPILIOTOPOULOS, do te zoteroje **25%** te Kapitalit Shoqeror
3. Z. Milto HODO, do te zoteroje **25%** te Kapitalit Shoqeror, dhe
4. Z. Artan BEQJA, do te zoteroje **25%** te Kapitalit Shoqeror,

Kerkojme depozitimin e ketij vendimi, prane Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Rrethit – Tirane.

**ADMINISTRATORI**

**Kujtim BEQJA**

PRODHIM BOJRASH
DORJAN SH.P.K
DURRES ALBANIA

**VENDIM**
**Nr. 8**

**I ASAMBLESE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**" DORJAN " Sh.p.k.**
**DURRES**

Sot, me daten Gjashtembedhjete tetor Dymijekater (**16./10.2004**), u zhvillua ne seline e kesaj Shoqerie, ne Durres, Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, " **DORJAN** ". Mbledhja filloi ne oren 16 dhe merrte pjese i gjithe kapitali shoqeror:

. **Z.** Kujtim BEQJA, i cili zoteron **25%** te kapitalit shoqeror,
. **Z.** Christos SPILIOTOPOULOS, i cili zotron **25%** te kapitalit shoqeror
. **Z.** Milto HODO, i cili zoteron **25%** te kapitalit shoqeror dhe
. **Z.** Artan BEQJA, i cili zoteron **25%** te kapitalit shoqeror

Mbledhja u zhvillua ne prani te **E**kspertes **K**ontabel te Autorizuar te Shoqerise, Znj. Nadire **HYSENI.**

Rendi i Dites, ishte:

1. Shqyrtimi per Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, nepermjet kalimit ne te, te fitimeve te realizuara nga viti 1995 deri 2003.
2. Te ndryshme, te mundeshme.

E merr fjalen Ekspertja, **Znj**. Nadire **HYSENI**, e cila relaton mbi gjendjen ekonomiko-financiare te Shoqerise.
Sipas treguesve te bilançeve te viteve 1998 deri 31.12.2003, Shoqeria " **DORJAN** " sh.p.k. ka rezultuar me fitime gjithmone ne rritje, nga viti ne vit.
Çdo vit ne kete Shoqeri, jane kryer investime ne blerje makineri e paisje per prodhim bojerash, si dhe jane shtuar kapacitetet prodhuese te Saj.
Numeri i fuqise puntore, nga viti 1995 deri 2003, eshte dyfishuar.
Bazuar ne rezultatet financiare, Ekspertja ka mendimin se per te rritur besueshmerine ne syte e te treteve, Shoqeria mund te rrise Kapitalin e saj Themeltar, duke i bashkuar atij ekzistuesi; **4.900.000** leke, qe perfaqsojne fitimet e mbartura ne vite.
Zmadhimi i Kapitalit Themeltar argumentohet, me gjendjen e aktiveve te qendrueshem qe Shoqeria ka ne bilançin e vitit 2003. Vlera bruto e tyre, eshte **6.124.177** leke.

Pas diskutimeve te çdo Ortaku, me te drejten vendimore qe parashikon ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "***Per Shoqerite Tregetare***" dhe "***Statuti i Shoqerise***", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve,

**VENDOSI:**

1. Te miratoje zmadhimin e kapitalit te Shoqerise, me **4.900.000** leke, duke i bashkuar atij fitimet e realizuara nga viti 1998 deri 2003.
2. Pas ketij veprimi, kapitali i Shoqerise " **DORJAN** " sh.p.k. te behet **5.000.000** leke.
3. Perberja ne kapital te Ortakeve, do te mbetet ajo qe eshte deri me sot:
   - Z.Kujtim BEQJA, zoteron **25%** te kapitalit shoqeror,
   - Z.Christos SPILIOTOPOULOS, zoteron **25%** te kapitalit shoqeror.
   - Z.Milto HODO, zoteron **25%** te kapitalit shoqeror, dhe
   - Z.Artan BEQJA, zoteron **25%** te kapitalit shoqeror,
4. Ky vendim te dergohet per depozitim ne Regjistrin Tregetar te Gjykates te Rrethit - TIRANE.

Vendimi i mesiperm, redaktohet ne tre orgjinele, me vlere te njejte.

***ORTAKET***: Kujtim **BEQJA**
Christos **SPILIOTOPOULOS**
Milto **HODO**
Artan **BEQJA**

# RAPORT

# I

# EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Mbeshtetur ne misionin qe me eshte besuar nga Gjykata e Rrethit Tirane, Vendim nr.13.167/8, date 08.07.2004, per argumentimin e shtimit te kapitalit Themeltar te shoqerise "**DORJAN**" sh.p.k. – Durres, kam nderin te paraqes konkluzionet e meposhteme:

**ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR**, duke kaluar ne te rezervat e krijuara nga fitimet e realizuara nga viti 1995 deri ne v. 2003.

Nga verifikimi i dokumentave te Shoqerise "**DORJAN**" sh.p.k. – Durres, rezulton se me vendim te Gjykates se Tiranes, Nr. 13167, date 22/12/1995, eshte krijuar si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me **kapital themeltar 100.000** leke. Gjat viteve, kjo Shoqeri ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe kuotat e tyre. Nga dt. 22.12.1995 e deri me sot, kjo Shoqeri ka zhvilluar aktivitet prodhimi dhe tregetimi te bojerave.

Me vendimin e Gjyketes te Rrethit Tirane nr. 13167/8, date 08.07.2004, shoqeria "**DORJAN**" sh.p.k. me administrataor Z. Kujtim BEQJA, ka kater ortake, me nga 25% te kapitalit themeltar secili prej tyre.

Sipas bilanceve financiare te paraqitura per keto vite, Shoqeria ka rezultuar me **fitime** qe kapin vleren, **7.096.571** leke.

Per te siguruar vijueshmerine e veprimtarise ekonomike te Shoqerise dhe rritjen e kredibilitetit te saj ne syte e te treteve, Ortaket, Zoterinjte: Kujtim BEQJA, Christos SPILIOTOPOULOS, Milto HODO dhe Artan BEQJA,, me vendimin Nr. 8, dt. 16.06.2004, te Asamblese se Jashtezakoneshme, ***vendosen qe:***

**Fitimin e Pashperndare** te viteve 1995-2003, per **4.900.000** leke, mbeshtetur ne Nenin 150 te Ligjit Nr. 7638, dt. 19/11/1992, "*Per shoqerite tregtare*", ta kalojne ne ***Zmadhim te Kapitalit Themeltar te Shoqerise***.

Nga ana ime u be kontrolli ligjor i llogarive vjetore, bazuar ne vlerat kontabile te bilancit date 31/12/2003 te shoqerise "**DORJAN**" sh.p.k – Durres.

***Ne perfundim te ketij kontrolli,*** ***<u>konkludoj se:</u>***

| | |
|---|---|
| Aktivet e Qendrueshme te Shoqerise jane : | **6.124.177** leke. |
| Aktivet Qarkulluese : | **6.560.852** leke |
| Detyrimet sipas bilancit : | **1.261.911** leke |
| Kapitalet e Veta te Shoqerise : | **11.423.118** leke |

Detyrimet e shoqerise jane ndaj Ortakeve, ato ne kuptimin ligjor te tyre nuk quhen detyrime, pasi perfaqesojne mjetet financiare te Ortakeve te vena ne perdorim te Shoqerise, pa interes e pa afat, per blerjen e Aktiveve te Shoqerise per vazhdimin e veprimtarise ekonomike te saj.

Nga analiza e treguesve te mesiperm te bilancit te vitit 2003, *<u>mendoj se</u>*: ***Zmadhimi i Kapitalit te Shoqerise eshte i argumentuar dhe real.***

Mbeshtetur ne Ligjin "**Per shoqerite tregtare**", Nr. 7638, dt. 19/11/1992, ne Nenet 40, 62 dhe 150, si dhe ne vendimin Nr. 8, dt.16.06.2004, te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, *<u>arrij ne perfundimin se</u>*:

***Zmadhimi I Kapitalit te Shoqerise***, "***DORJAN***"" sh.p.k, Durres, nga **100.000** leke ne **5.000.000** leke, eshte i ***drejte*** dhe i ***argumentuar*** me kapitalet e veta te Shoqerise, me vleren e tyre : **11.423.118** leke.

*Durres, me 30.09.2004*

**EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR**
**Nadire HYSENI**

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR
NADIRE HYSENI
43 Dt 10.2.200[illegible]
DURRES ALBANIA

KERKESE

KERKUESI : Kujtim BEQJA, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, banues ne Tirane, administrator i shoqerise "DORIAN" shpk, me seli ne Durres.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimit nr.9 date 6.11.2006 te Asamblese se Ortakeve.

BAZA LIGJORE: Neni 20 i Ligjit nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", neni 47 i Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe neni 33 i Ligjit nr.7667 date 23.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar".

***GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR***
***TIRANE***

Z.Kryetar,

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres dhe aktivitet ne fushen e prodhimit dhe te tregtimit te bojrave, me ortake Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Artan Beqja dhe Milto Hodo, me administrator Kujtim Beqja, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit 13167 date 22.12.1995 dhe ka bere disa here ndryshime dhe aktualisht eshte me kapital themeltar 5.000.000 leke.

Me vendimin nr.9 date 6.11.2006 te Asamblese se Ortakeve, eshte vendosur:

Te miratoje emerimin e z.Rifat Muço, si ekspert kontabel i autorizuar per kryerjen e vleresimeve me qellim zmadhimin e kapitalit.

Duke qene se plotesohen kushtet qe kerkohen nga Ligji "Per Regjistrin Tregetar" dhe Statuti i shoqerise, kerkoj depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.9 date 06.11.2006.

Bashkelidhur nje kopje vendimi nr.9 date 06.11.2006 si dhe nje kopje te noterizuar te licences nr.89 date 02.02.2005 te ekspoertit kontabel te autorizuar z.Rifat Muco, leshuar nga IEKA.

KERKUESI
Kujtim BEQJA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE DURRES**
**Nr. 5761 REP. Nr. 1367 KOL.**

# PROKURE E POSACME

Në Durrës, sot më datën: 05/12/2006( Dy mijë e gjashte ), para meje noteres AIDA SPAHIU me zyrë noteriale në Rr."A.Goga"banesa 641 , Durrës; u paraqit :

**I PERFAQESUARI :**

**1-SHOQERIA 'DORIAN ' sh.p.k.** me qender ne Durres I rregjistruar ne organet tatimore me Kod fiscal 550834 me drejtues ligjor **KUJTIM BEQJA** I biri I Iljazit I datelindjes 07/11/1957 lindur dhe banues ne Tirane I identifikuar prej meje sipas ligjit madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e porositesit I cili kerkoi prej meje redaktimin e kesaj prokure te posacme si me poshte:------------------

Me te drejten qe me njeh dhe me lejon ligji **Caktoj dhe Emeroj** perfaqesues ligjor e te posacem te shoqerise ' Dorjan ' sh.p.k. shtetasin OLTI SKRAME I biri I Petraqit I datelindjes 07/05/1986 lindur dhe banues ne Durres , te cilit I jap tagrin ( te drejta ) te plota dhe te pakufizuara qe :

**Te kryeje** te gjitha veprimet e duhura ne emer dhe per llogari te shoqerise qe une drejtoj,para gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane ne lidhje me shtimin e kapitalit te shoqerise ' Dorian ' .------------------

Shtetasi Olti Skrame si perfaqesuesi I shoqerise 'Dorian ' sh.p.k. do te kete te gjitha te drejtat dhe kopetencat ta perfaqesoje shoqerine ne fjale para Gjykates Tirane duke nenshkruar cdo document te nevojshem deri ne terheqjen perfundimtare te vendimit te kesaj Gkykate vendim I cili shton Kapitalin e shoqerise 'Dorian ' .-------

**Te gjitha keto tagra** nga une drejtuesi ligjor I shoqerise 'Dorian 'sh.p.k. do te konsiderohen te drejta dhe te ligjshme sikur t'I kem kryer personalisht.

**Prokura eshte e vlefshme** derisa te realizohen tagrat e mesiperme si dhe per aq kohe sa nuk eshte revokuar prej meje.------------------

**Prokura,** lexohet me zë dhe qartë e cila pranohet siç është redaktuar dhe me vullnet te lire dhe te plote e nenshkruaj ate pa asnje verejtje para noterit.—

**Sa sipër,**unë noterja, e vërtetoj,sipas ligjit 7829 dt.01.06.94, **"Për noterinë"**

**LËSHUESI I PROKURËS ( I PERFAQESUARI )**

**SHOQERIA 'DORIAN ' sh.p.k.**

**Me drejtesu ligjor KUJTIM BEQJA**

PRODHIM BOJRASH
DORJAN SH.P.K.
DURRES ALBANIA

**N O T E R E**

**AIDA SPAHIU**

SHOQERIA "DORIAN" SH.P.K.
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

**_VENDIM_**
**_NR.9 DATE 06.11.2006_**

Asambleja e ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, e perbere nga Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodo, Artan Beqja, mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise, dhe

KONSTATOI SE:

Shoqeria "DORIAN" sh.p.k., me qender ne Durres, me aktivitet prodhimin dhe tregetimin e bojrave, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane. Kjo shoqeri ka bere disa here ndryshime, te cilat jane depozituar ne Regjistrin Tregetar me vendimet perkatese te menoneshme. Keto ndryshime konsistojne ne emrin e shoqerise, ne ortaket pjesemarres, ne kuotat e tyre te kapitalit shoqeror si dhe ne vleren gjithsej te kapitalit shoqeror.

Aktualisht shoqeria DORIAN shpk, ka nje kapital prej 5.000.000 leke, qe zoterohet nga ortaket Kujtim Beqja, Christos Spiliotopuolos, Milto Hodo dhe Artan Beqja nga 25% secili.

Duke shqyrtuar aktivitetin e shoqerise DORIAN shpk, ortaket jane te mendimit qe kapitali mund te zmadhohet ne natyre, duke perdorur per kete fitimet e pashperndara.

Me qellim zmadhimin e kapitalit, ortaket mendojne qe, per vleresimet, te emerohet si ekspert kontabel i autorizuar z. Rifat Muco, i cili i ploteson kushtet e kerkuara nga ligji, ka eksperiencen e nevojeshme dhe gezon besimin e ortakeve per kryerjen e vleresimeve.

Ky veprim eshte ne perputhje me statutin e shoqerise dhe me lgijin nr.7638 date 19.11.1992.

PER KETE ARESYE

Asambleja e Ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, duke u mbeshtetur ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne statutin e shoqerise,

V E N D O S I :

1. Zmadhimin e kapitalit ne natyre.
2. Emerimin e z.Rifat Muco, si ekspert kontabel i autorizuar.

2. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne Gjykaten e Rrethit Tirane, per t'u bere shenimet perkatese ne Skeden e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Ky vendim hyn ne fuqi me nenshkrimin e tij nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

KUJTIM BEQJA CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODO ARTAN BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1394 NR.KOL. 500

***VERTETIM***

Sot, me daten 07.11.2006 (shtate nentor dymijegjashte) une noterja Shpresa Skrame, ne zyren time ne Durres, Lagje nr.2, rruga A.Goga, ne baze te Ligjit nr.7829 date 01.06.1994, vertetoj nenshkrimet e personave te mesposhtem, ortaket pjesemarres te shoqerise DORIAN shpk, me qender ne Durres, te njohur personalisht prej meje, te cilet jane:-------

***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane.

***Christos SPILIOTOPUOLOS,*** i biri i Nikolaos, dtl. 09.05.1940, lindur dhe banues ne Attikis, Greqi.------

***Milto HODO***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster dhe banues ne Durres.-----------

***Artan BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane.

PULLE TAKSE

N O T E R E
SHPRESA SKRAME

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1394 NR.KOL. 500

## *VERTETIM*

Sot, me daten 07.11.2006 (shtate nentor dymijegjashte) une noterja Shpresa Skrame, ne zyren time ne Durres, Lagje nr.2, rruga A.Goga, ne baze te Ligjit nr.7829 date 01.06.1994, vertetoj nenshkrimet e personave te mesposhtem, ortaket pjesemarres te shoqerise DORIAN shpk, me qender ne Durres, te njohur personalisht prej meje, te cilet jane:-------
***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane.
***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl. 09.05.1940, lindur dhe banues ne Attikis, Greqi.------
***Milto HODO***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster dhe banues ne Durres.-----------
***Artan BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane.---
Qe deklaruan se nenshkrimet jane te tyre dhe te vena me deshire te plote dhe vullnet te lire. Po keshtu edhe ortaku grek Christos Spiliotopoulos, te cilit i perktheva tekstin e mesiperm.---------

NOTERE
SHPRESA SKRAME

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE
## (IEKA)

# LICENSE

*Kjo license i leshohet ,* Rifat Remzi Muço

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR .**

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin:* 89 *, sipas kesaj liste.*

**PRESIDENTI**

(Baki Berberi)

Berberi

*Leshuar me,* 02 Shkurt 2005

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 1394 DATE 07.11.2006

PULLE TAKSE

VERTETIM

Vertetoj se para meje noteres, ne zyren time, ne Lagjen nr.2, rruga A.Goga, Durres, u paraqit personalisht shtetasi: Kujtim Beqja, administrator i DORIAN shpk, identiteti sipas ligjit, i cili paraqiti para meje ne orgjinal dhe fotokopje dokumentin: Licence e ekspertit kontabel te autorizuar, Rifat Muco, me nr.regj.89 leshuar me 02.02.2005 nga IEKA.

Ky dokument eshte pa korigjime, shtesa, fshirje ose shenja te tjera te dyshimta.

Vertetoj njesine me origjinalin sipas ligjit nr.7829 date 1.06.1994.

NOTERE
SHPRESA SKRAME

# KERKESE

KERKUESI : Kujtim BEQJA, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, banues ne Tirane, administrator i shoqerise "DORIAN" shpk, me seli ne Durres.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimeve nr.10 date 30.12.2006 dhe nr.11 date 24.01.2007 te Asamblese se Ortakeve.

BAZA LIGJORE: Neni 20 i Ligjit nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit Tregetar", neni 47 i Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe neni 33 i Ligjit nr.7667 date 23.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar".

## *GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR*
## ***TIRANE***

Z.Kryetar

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres dhe aktivitet ne fushen e prodhimit dhe te tregetimit te bojrave, me ortake Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Artan Beqja dhe Milto Hodo, me administrator Kujtim Beqja, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit 13167 date 22.12.1995 dhe ka bere disa here ndryshime dhe aktualisht eshte me kapital themeltar 5.000.000 leke.

Me vendimin ***nr.9 date 6.11.2006*** te Asamblese se Ortakeve, eshte vendosur:

***Zmadhimi i kapitalit dhe emerimi*** i z.Rifat Muço, si ***ekspert kontabel i autorizuar.***

Me vendimin nr.***13167/10 date 26.12.2006*** te gjyqtarit te vetem, eshte ***vendosur depozitimi*** i vendimit te mesiperm.

Eksperti kontabel i autorizuar ka hartuar Akt-ekspertimin e tij ku vertetohet qe kapitali ne natyre i kesaj shoqerie mund te zmadhohet duke u bere 10.000.000 leke nga 5.000.000 leke qe eshte aktualisht, pasi 10.000.000 leke eshte vlera ne natyre e kapitalit te shoqerise. Ky ***aktekspertimi eshte miratuar*** nga Asambleja e Ortakeve me vendimin e saj ***nr.10 date 30.12.2006.***

Vec, kesaj Asambleja e Ortakeve, mendon qe te shtoje aktivitetin e shoqerise edhe me aktivitet ne fushen e ndertimit per vete, sipas licences qe do te leshohet nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve. Per kete qellim, pasi eshte punesuar drejtuesi teknik, Inxhinjer Ulsi Toqi, i pajisur me Licence profesionale nr.Z1666/4, Asambleja e Ortakeve me vendimin ***nr.11 date 24.01.2007***, ka miratuar ***shtimin*** e aktivitetit te shoqerise me ***aktivitet ne fushen e ndertimit per vete.***

Duke qene se plotesohen kushtet qe kerkohen nga Ligji "Per Regjistrin Tregetar" dhe Statuti i shoqerise, kerkoj depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.10 date 30.12.2006 si dhe te vendimit nr.11 date 24.01.2007.

Bashkelidhur nje kopje vendimi nr.10 date 30.12.2006 te Asamblese se Oratekeve, si dhe nje kopje te akt-ekspertizes se ekspertit kontabel te autorizuar z.Rifat Muco; nje kopje vendimi nr.11 date 24.01.2007 te Asamblese se Ortakeve, nje kopje te vertetuar te licences se drejtuesit teknik, kontraten e punes.

KERKUESI
Kujtim BEQJA

PRODHIM BOJRASH
DORJAN SH.P.K
DURRES ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE DURRES**
**Nr.** 1761 **REP. Nr.** 1387 **KOL.**

# PROKURE E POSACME

Në Durrës, sot më datën: 05/12/2006( Dy mijë e gjashte ), para meje noteres AIDA SPAHIU me zyrë noteriale në Rr."A.Goga"banesa 641 , Durrës; u paraqit :

**I PERFAQESUARI :**

**1-SHOQERIA 'DORIAN ' sh.p.k.** me qender ne Durres I rregjistruar ne organet tatimore me Kod fiscal 550834 me drejtues ligjor **KUJTIM BEQJA** I biri I Iljazit I datelindjes 07/11/1957 lindur dhe banues ne Tirane I identifikuar prej meje sipas ligjit madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e porositesit I cili kerkoi prej meje redaktimin e kesaj prokure te posacme si me poshte:------------------

Me te drejten qe me njeh dhe me lejon ligji **Caktoj dhe Emeroj** perfaqesues ligjor e te posacem te shoqerise ' Dorjan ' sh.p.k. shtetasin OLTI SKRAME I biri I Petraqit I datelindjes 07/05/1986 lindur dhe banues ne Durres , te cilit I jap tagrin ( te drejta ) te plota dhe te pakufizuara qe :

**Te kryeje** te gjitha veprimet e duhura ne emer dhe per llogari te shoqerise qe une drejtoj para gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane ne lidhje me shtimin e kapitalit te shoqerise ' Dorian ' .------------------

Shtetasi Olti Skrame si perfaqesuesi I shoqerise 'Dorian ' sh.p.k. do te kete te gjitha te drejtat dhe kopetencat ta perfaqesoje shoqerine ne fjale para Gjykates Tirane duke nenshkruar cdo document te nevojshem deri ne terheqjen perfundimtare te vendimit te kesaj Gkykate vendim I cili shton Kapitalin e shoqerise 'Dorian ' .-------

**Te gjitha keto tagra** nga une drejtuesi ligjor I shoqerise 'Dorian 'sh.p.k. do te konsiderohen te drejta dhe te ligjshme sikur t'I kem kryer personalisht.

**Prokura eshte e vlefshme** derisa te realizohen tagrat e mesiperme si dhe per aq kohe sa nuk eshte revokuar prej meje.-----------------

**Prokura,** lexohet me zë dhe qartë e cila pranohet siç është redaktuar dhe me vullnet te lire dhe te plote e nenshkruaj ate pa asnje verejtje para noterit.—

**Sa sipër,**unë noterja, e vërtetoj,sipas ligjit 7829 dt.01.06.94, **"Për noterinë"**

**LËSHUESI I PROKURËS ( I PERFAQESUARI )**

**SHOQERIA 'DORIAN ' sh.p.k.**

**Me drejtesu ligjor KUJTIM BEQJA**

PRODHIM BOJRASH
DORJAN SH.P.K
DURRES ALBANIA

**N O T E R E**

**AIDA SPAHIU**

GJYKATES

Akt- Ekspertize

Per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise
" Dorjan " Shpk Durres

Une Refat Muco , Ekspert Kontabel i Autorizuar , i licensuar me nr. 89 date 02.02.2005 , me NIPT-in nr.61606509H ,me cilesine e Ekspertit te vleresimit te kapitalit te shoqerise " Dorjan " Shpk , i caktuar mbi bazen e vendimit nr. 9 date 06.11.06 te Asamblese se ortakeve te shoqerise " Dorjan " shpk , duke patur parasysh dhe nenet 168 dhe 169 mbi papajtueshmerine mbi emerimin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " per te bere nje raport per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ,jam mbeshtetur ne dokumentat qe vijojne:

I.- Dokumentat ligjore :

1.- Vendimin e gjykates se rrethit Tirane nr.13167 date 22.02.1995 me ane te te cilit shoqeria " Dorjan " Shpk eshte e regjistruar si person juridik .

2.- Statutin dhe akt-themelimin e shoqerise .

3.- Certefikaten e regjistrimit ne organet tatimore me kod fiskal .

4.- Numuri i identifikimit te personit te tatueshem .

5.- Vendimin e ortakut te vetem per emerimin si Ekspert Kontabel te Autorizuar .

II.- Dokumenta ekonomike :

1.- Bilancin kontabel te fundit te vitit 2005.

2.- Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar mbi opinionin per bilancin e vitit 2005.

3.- Ne inventarin kontabel te aktiveve dhe pasiveve te perpiluara nga shoqeria dhe te studiuara per vleresimin e tyre .

4.- Dokumenta te tjera dhe spjegime te kerkuara nga ana e jone ne mbeshtetjen e ketij raporti .

Mbasi studiova dhe ekspertova te gjithe dokumentacionin e shoqerise qe lidhet me zmadhimin e kapitalit themeltar ,rezultoi gjendja si me poshte ;

A.- Ne pasive te bilancit kontabel :

| | Ne leke |
|---|---|
| Kapitali themeltar | 5.000.000 |
| Rezerva ligjore | 200.000 |
| Rezerva te tjera | 266.000 |
| Fitimi pas tatimit | 4.079.038 |

Lehtesite tatimore 1.455.802

B.- Ne aktiv te bilancit kontabel :

Burimet financiare te lartpermendura jane materializuar ne shoqeri ne rubriken e aseteve ( si instalime teknike ,makineri –pajisje dhe te mjeteve te transportit ) si dhe nje pjese ne aktivet qarkulluese ,te cilat paraqiten si me poshte :

| | Ne leke |
|---|---|
| Instalime teknike ,makineri Pajisje | 3.935.270 |
| Mjete transporti | 3.755.780 |
| Materilae te para dhe materiale te tjera | 8.119.984 |
| Likujditete dhe vlera te tjera | 1.006.097 |

Ne keto kushte ,vendimi i orakeve per zmadhimin e kapitalit themeltar ne shumen 5.000.000 leke ,duke perdorur si burim "Fitimin e vitit ushtrimor " dhe " Lehtesite tatimore te perfituara " ,te cilat shtojne fitimin e vitit 2005 , te pasqyruara ne bilanc , eshte nje vendim i drejte , i bazuar ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "ne nenet 40 ,62 si dhe ne vendimin nr.9 date 06.11.2006 te Asamblese se ortakeve .

Ne perfundim :

Pas kalimit te shumes ,si rezultat i zmadhimit te kapitalit ,rubrika Pasivi i bilancit per kapitalin themeltar ,paraqitet si me poshte :

Ne leke

| Emertimi i posteve | Ishte | Behet |
|---|---|---|
| Kapitali themeltar | 5.000.000 | 10.000.000 |

Si rezultat i kesaj gjendje dhe i veprimeve ne baze te vendimit te Asamblese se Oratekeve te shoqerise ,duhet kryer veprimi kontabel :

Debit llogaria 107 " Fitime te mbartuara"per 5.000.000 leke .

Kredit llogaria 456 " Ortaket veprime me kapitalin " per 5.000.000 leke .

Debit 456 " Oraket veprime me kapitalin " per 5.000.000 leke

Kredit 101 " kapitali themeltar" per 5.000.000 leke.

Mbas perfundimit te ketij veprimi kontabel ,kapitali themeltar do te formohet si me poshte :

| | | |
|---|---|---|
| Kapitali i themelimit | | 5.000.000 leke |
| Shtese kapitali | | 5.000.000 leke |
| | Totali | 10.000.000 leke |

Zoterues te ketij kapitali prej 10.000.000 leke jane oraket qe permenden ne vendimin date 06.11.2006 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise " Dorjan " Shpk .

Per sa siper hartohet ky akt-ekspertimi ne 3 ( tre ) kopje te njejta ,nga te cilat dy i lihen shoqerise " Dorjan " Shpk dhe nje e mban Eksperti Kontabel i Autorizuar .

NOTER DURRES

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Refat Muco

DR. RIFAT MUCO EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Durres 30.12.2006

GJYKATE

Taksa u likujdua

NOTERE Shpresa SKRAME

SHOQERIA "DORIAN" SH.P.K.
Lagje nr.14, Shkozet, DURRES
K.Fiskal 540834
NIPT J61813528H
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

***VENDIM***

***NR.10, DATE 30.12. 2006***

Asambleja e ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, e perbere nga Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodo, Artan Beqja, mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise, dhe

KONSTATOI SE:

Shoqeria "DORIAN" sh.p.k., me qender ne Durres, me aktivitet prodhimin dhe tregetimin e bojrave, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane. Kjo shoqeri ka bere disa here ndryshime, te cilat jane depozituar ne Regjistrin Tregetar me vendimet perkatese te menoneshme.

Vlera e kapitalit te kesaj shoqerie eshte 5.000.000 leke, qe zoterohet ne menyre te barabarta nga 25% secili nga ortaket, te cilet mendojne se vlera e ketij kapitali mund te rritet akoma.

Me qellim zmadhimin e kapitalit, ortaket kane vendosur, per vleresimet, te emerohet si ekspert kontabel i autorizuar z. Rifat Muco. Ky vendim eshte pranuar per depozitim nga Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane, me ane te vendimit nr.13167/10 date 26.12.2006.

Eksperti kontabel i autorizuar ka hartuar akt ekspertizen e tij, sipas te cilit kjo shoqeri ka mundesine te perdore fitimet e pashperndara per zmadhimin e kapitalit nga 5.000.000 leke qe eshte aktualisht, te behet 10.000.000 leke.

Asambleja e Ortakeve e mori ne shqyrtim akt espertimin, e miraton ate dhe eshte dakord qe kapitali shoqeror nga 5.000.000 leke qe eshte aktualisht, te zmadhohet edhe me 5.000.000 leke te tjera, duke u bere 10.000.000 leke.

Ky veprim eshte ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe me Ligjin nr.7638 date 19.11.1992.

PER KETE ARESYE

Asambleja e Ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, duke u mbeshtetur ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne statutin e shoqerise,

VENDOSI:

1. Miratimin e aktekspertimit te z.Rifat Muco, ekspert kontabel i autorizuar, per zmadhimin e kapitalit nga 5.000.000 leke ne 10.000.000 leke.

2. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne Gjykaten e Rrethit Tirane, per tu bere shenimet perkatese ne Skeden e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Ky vendim hyn ne fuqi me nenshkrimin e tij nga ortaket.

**<u>ASAMBLEJA E ORTAKEVE</u>**

KUJTIM BEQJA

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODO

ARTAN BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 51 NR.KOL. 18

# *VERTETIM*

Sot, me daten 09.01.2007 (nente janar dymijeshtate) une noterja Shpresa Skrame, ne zyren time ne Durres, Lagje nr.2, rruga A.Goga, ne baze te Ligjit nr.7829 date 01.06.1994, vertetoj nenshkrimet e personave te mesposhtem, ortaket pjesemarres te shoqerise DORIAN shpk, me qender ne Durres, te njohur personalisht prej meje, te cilet jane:-------

***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane.

***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl. 09.05.1940, lindur dhe banues ne Attikis, Greqi.------

***Milto HODO***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster dhe banues ne Durres.-----------

***Artan BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane.---

Qe deklaruan se nenshkrimet jane te tyre dhe te vena me deshire te plote dhe vullnet te lire. Po keshtu edhe ortaku grek Christos Spiliotopoulos, te cilit i perktheva tekstin e mesiperm.---------

NOTERE
SHPRESA SKRAME

SHOQERIA "DORIAN" SH.P.K.
Lagje nr.14, Shkozet, DURRES
K.Fiskal 540834
NIPT J61813528H
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

***VENDIM***

***NR.11, DATE 24.01. 2007***

Asambleja e ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, e perbere nga Kujtim Beqja, Christos Spiliotopoulos, Milto Hodo, Artan Beqja, mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise, dhe

KONSTATOI SE:

Shoqeria "DORIAN" sh.p.k., me qender ne Durres, me aktivitet prodhimin dhe tregetimin e bojrave, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane. Kjo shoqeri ka bere disa here ndryshime, te cilat jane depozituar ne Regjistrin Tregetar me vendimet perkatese te menoneshme. Keto ndryshime konsistojne ne emrin e shoqerise, ne ortaket pjesemarres, ne kuotat e tyre te kapitalit shoqeror si dhe ne vleren gjithsej te kapitalit shoqeror.

Aktualisht shoqeria DORIAN shpk, ka si aktivitet te saj kryesor prodhim dhe tregtim bojrash. Asambleja e Ortakeve deshiron qe ne objektin e veprimtarise te ***shtohet edhe aktiviteti i ndertimit per vete***, duke patur parasysh se:

Zhvillimi dhe zgjerimi i aktivitetit ka lindur nevojen per te zgjeruar ambientet e punes, pasi sot punohet ne ambiente te privatizuara te marra me qira.

Shoqeria DORIAN shpk, ka ne pronesi nje sasi toke prej 13.360 m2, te fituar me ane te blerjes dhe te regjistruar ne emer te saj ne ZRPP Durres.

Asambleja e Ortakeve eshte e mendimit qe shoqeria DORIAN shpk, i ploteson kushtet materiale e njerezore, qe te kryeje vete ndertimin e fabrikes mbi kete toke.

Per kete qellim eshte punesuar si ***drejtues teknik per ndertimet***, inxhinjeri Ulsi Toqi, i cili eshte i pajisur me licencen nr.Z1666/4 nga Sektori i Licencave te Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Fillimi ketij aktiviteti te ri, behet i mundur pasi te depozitohet ky vendim ne Skeden perkatese te shoqerise ne Regjistrin Tregetar dhe pas kesaj, shoqeria te pajiset me licence per ndertim nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Ky veprim eshte ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe me Ligjin nr.7638 date 19.11.1992.

PER KETE ARESYE

Asambleja e Ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, duke u mbeshtetur ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne Statutin e shoqerise,

VENDOSI:

1. Shtimin e objektit te shoqerise me aktivitet ne fushen ***e ndertimit per vete,*** sipas licences qe do te leshohet nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

2. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne Gjykaten e Rrethit Tirane, per tu bere shenimet perkatese ne Skeden e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Ky vendim hyn ne fuqi me nenshkrimin e tij nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

KUJTIM BEQJA

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODO

ARTAN BEQJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
Kodi Fiskal 540142 NIPT K31514532L
Lagje nr.2 Rruga A.Goga
Tel.Fax. (052) 30267
NR.REP. 160 NR.KOL. 61

Taksa u Likujdua
NOTERE Shpresa SKRAME
NOTER DURRES

# *VERTETIM*

Sot, me daten 26.01.2007 (njezetegjashte janar dymijeshtate) une noterja Shpresa Skrame, ne zyren time ne Durres, Lagje nr.2, rruga A.Goga, ne baze te Ligjit nr.7829 date 01.06.1994, vertetoj nenshkrimet e personave te meposhtem, ortaket pjesemarres te shoqerise DORIAN shpk, me qender ne Durres, te njohur personalisht prej meje, te cilet jane:-------
***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 07.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane.
***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl. 09.05.1940, lindur dhe banues ne Attikis, Greqi.------
***Milto HODO***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster dhe banues ne Durres.-----------
***Artan BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane.---
Qe deklaruan se nenshkrimet jane te tyre dhe te vena me deshire te plote dhe vullnet te lire. Po keshtu edhe ortaku grek Christos Spiliotopoulos, te cilit i perktheva tekstin e mesiperm.---------

NOTERE
SHPRESA SKRAME

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT

**Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale**

# LIÇENSE

## Z.1666/4



| | |
|---|---|
| MBIEMRI | TOQI |
| EMRI | ULSI |
| ATESIA | BILAL |
| DATELINDJA | 20.07.1967, Tirane |
| VENDBANIMI | TIRANE |
| DIPLLOMUAR, ME | 1991 |
| TITULLI | Ing.Ndertimi Civile Industriale |
| Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data | 27.07.2006 |

**NE ZBATIM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kat. | 1 | | Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme – prishje dhe punime ne toke te germuar. |
| Kat. | 2 | a | Prodhim materiale inerte - gure . |
| | | c | Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme – paranderur – gure dekorativ |
| | | e | Prodhim materiale me baze bitumi – sintetik. |
| Kat. | 3 | | a , b , c Ndertime civile dhe ekonomike |
| Kat. | 6 | a | Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m. |
| Kat. | 8 | a | Ndertim ujsjelles – kanalizime – kanale e impiante vaditje |
| Kat. | 9 | a | Silosa, kulla, kulla uji etj prej b/arme - metalike. |
| | | c | Izolime mbi dhe nen tokesore nga ujrat. |
| Kat. | 11 | a | Punime karpentjerie druri |
| | | b | Punime karpentjerie metalike |
| Kat. | 12 | c | Instalimi I impianteve higjenike,kuzhina,lavanteri,hidrosanitare – mirembajtja e tyre |
| | | e | Instalimi I materialeve prej druri – metalike plastike – xhami |
| | | f | Punime bojatisje – hidroizolim – termoizolim – akustike – kundra zjarrit |
| Kat. | 14 | b | Pastrimi I siperfaqes urbane. |
| | | c | Kryerja e punimeve ne sherbesa funerale |

**NE PROJEKTIM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kat. | 3 | a | Objekte civile – Industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate. |

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**Stavri RISTANI**

SEKRETARIA TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 117 DATE 16.01.2007

## VERTETIM

Vertetoj se para meje noteres, ne zyren time, ne Lagjen nr.2, rruga A.Goga, Durres, u paraqit personalisht shtetasi: ---------
***Ulsi TOQI***, i biri i Bilalit, dtl. 20.07.1967, lindur dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, identiteti sipas pasaportes nr.Z0504733, i cili paraqiti para meje ne origjinal dhe fotokopje dokumentin:
**LICENCE NR.Z.1666/4** e Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Ky dokument eshte pa korigjime, shtesa, fshirje ose shenja te tjera te dyshimta.

Vertetoj njesine me origjinalin sipas ligjit nr.7829 date 1.06.1994.

NOTERE
SHPRESA SKRAME

PULLE TAKSE 100

SHOQERIA "DORIAN" SH.P.K.
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

***VENDIM***

***NR. 8 DATE 16.06 2004***

Asambleja e ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, e perbere nga Kujtim BEQJA, Christos SPILIOTOPOULOS, Dhimitri LULEME, Milto HODO, Artan BEQJA, mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise, dhe

KONSTATOI SE :

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durrës, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe, aktualisht perbehet nga pese ortaket e shënuar me lart, qe perbejne Asamblene e Ortakeve dhe qe zoterojne secili prej tyre nga 20% te kuotave. Aktiviteti i kesaj shoqerie nuk ka ndryshuar dhe, kryesisht është ne fushen e prodhimit e te tregetimit te bojrave, administrator është Kujtim Beqja.

Sipas treguesve te bilanceve te viteve te kaluara, shoqeria DORIAN shpk, ka rezultuar me fitime gjithmone ne rritje, çdo vit ne kete shoqeri janë kryer investime ne blerje makineri e pajisje si dhe janë shtuar kapacitete prodhuese te saj.

Kjo gjendje ben te domosdoshme qe, per te rritur edhe besueshmerine tek te tretet shoqeria mund te beje rritjen e kapitalit kapitalit.

Per te bere te mundur fillimin e procedurave per zmadhimin e kapitalit, Asambleja e Ortakeve emeron si ekspert kontabel, zj.Nadire Hyseni

Keto ndryshime nuk bien ndesh dhe janë ne perputhje me statutin e shoqerise dhe me ligjin nr.7638 date 19.11.1992.

PER KETE ARESYE

Asambleja e Ortakeve e shoqerise "DORIAN" shpk, duke u mbeshtetur ne nenin 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992, dhe ne statutin e shoqerise,

***VENDOSI***

1. Te miratoje zj.Nadire Hyseni, si eksperte kontabel per te kryer vleresimet dhe procedurat e nevojeshme per zmadhimin e kapitalit.

2. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne Gjykaten e Rrethit Tirane per t'u bere shenimet perkatese ne Skeden e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Ky vendim hyn ne fuqi me nenshkrimin e tij nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

KUJTIM BEQJA CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODO ARTAN BEQJA DHIMITRI LULEME

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 619 NR.KOL.104

***<u>VERTETIM</u>***

Sot, me daten 16.06.2004 (gjashtembedhjete qershor dymijekater) para meje noteres Shpresa SKRAME, u paraqiten personalisht personat e poshteshenuar:

***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas pasaportes nr.Z0893612;

***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl.09.05.1940, lindur dhe banues ne Agioi Anargyroi, Attikis, Greqi, identiteti sipas pasaportës nr.767761.

***Dhimitri LULEME***, i biri i Shomos, dtl. 1.07.1964, lindur ne Gjirokaster, banues ne Kavaje, identiteti sipas pasaportës nr.0252364;

***Milto HODAJ***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster, banues ne Durrës, identiteti sipas pasaportës nr.Z0072358.

**Artan BEQJA**, i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas pasaportës nr.0463710

te cilet nenshkruan sa me siper sipas deshires dhe vullnetit te tyre te lire.

Unë, noterja, bazuar ne Ligjin nr.7829 datë 1.6.1994, vertetoj.

NOTERE
Shpresa SKRAME

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP. 575 NR.KOL. 94

***KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH***
***TE SHOQERISE "DORIAN" SHPK***

Ne Durres, sot me daten 3.6.2004 (tre qershor dymijekater ~~dymijetre~~), para meje noteres Shpresa Skrame, ne zyren time, ne lagjen nr.2, rruga A.Goga, nr.15, u paraqiten personat e poshteshenuar dhe kerkuan redaktimin e kontrates se shitblerjes se kuotave te shoqerise "DORIAN" shpk :

***SHITESI*** ***: Dhimitri LULEME***, i biri i Shomos, dtl.01.07.1964, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Kavaje, me zotësi te plotë per te vepruar, identiteti sipas pasaportës nr.0252364..

***BLERESAT*** ***: Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl.07.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, me zotësi te plotë per te vepruar, identiteti sipas pasaportës nr.Z0893612.

***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl.09.05.1940, lindur dhe banues ne Agioi Anargyroi, Attikis, Greqi, identiteti sipas pasaportës nr.767761.

***Milto HODO,*** i biri i Avniut, dtl.28.02.1962, lindur ne Mallakaster, banues ne Durrës, identiteti sipas pasaportës nr.Z0082358.

***Artan BEQJA,*** i biri i Iljazit, dtl. 27.02.1966, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas pasaportës nr.0463710.

Te cilet me deshire te plote dhe vullnet te lire me deklaruan se kane rene dakord te lidhin nje kontrate shitblerje kuotash si vijon:

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durres, me aktivitet ne te gjithe vendin me objekt prodhim e tregim bojrash, e njohur dhe regjistruar si person juridik me ane te vendimit nr.131167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime, dhe aktualisht perbehet nga pese ortake, qe janë personat e sipershenuar, me nga 20% te kuotave ose 20.000 leke secili.

Ortaku Dhimitri Luleme largohet nga shoqeria dhe i shet ne pjese te barabarta, kuotat e tij te pjesemarrjes ne kapitalin shoqeror, ortakeve te tjere, te cilët pranojne ti blejne, duke u bere keshtu secili prej tyre me nga

25% ose 25.000 leke ne pjesemarrjen ne kapitalin shoqeror, i cili eshte 100.000 leke. Ndermjet paleve, sipas deklarimit te tyre, jane kryer likuidimet perkatese jashtë zyres noteriale dhe nuk kane asnje pretendim ndaj njeri tjetrit.

Me ane te kesaj kontrate behet kalimi i pronesise te kuotave nga ortaku qe largohet tek kater ortaket qe mbeten.

U lexua, kuptohet nga palet dhe nenshkruhet prej tyre para meje noteres.

Per ortakun Chistos Spiliotoupolos, komunikimi është bere me ane te perkthyesit Kristo Lavari, banues ne Durrës, person i njohur nga unë.

Nenshkrimi është bere ne data te ndryshme, e fundit nga te cilat është data e shënuar ne hyrje te kesaj kontrate.

Une, noterja, bazuar ne nenet 705 e vijues te K.Civil dhe ligjin 7829 date 1.6.1994, vertetoj.

SHITESI
DHIMITRI LULEME

KUJTIM BEQJA

MILTO HODO

BLERESAT ΣΠΗΛΙΩΤΟΠΟΥΛΟΣ ΧΡΗΣΤΟΣ
CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

ARTAN BEQJA

***NOTERE***
***Shpresa SKRAME***

SHOQERIA "DORIAN" SH.P.K.
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

***V E N D I M***

***NR. 7 DATE 3.6.2004***

Asambleja e ortakeve e Shoqerise "DORIAN" shpk, e perbere nga Kujtim BEQJA, Christos SPILIOTOPOULOS, Dhimitri LULEME, Milto HODO, Artan BEQJA, mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise, dhe

KONSTATOI SE :

Shoqeria "DORIAN" shpk, me qender ne Durrës, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar me ane te vendimit nr.13167 date 22.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, ka bere disa here ndryshime ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe, aktualisht perbehet nga pese ortaket e shënuar me lart, qe perbejne Asamblene e Ortakeve dhe qe zoterojne secili prej tyre nga 20% te kuotave. Aktiviteti i kesaj shoqerie nuk ka ndryshuar dhe, kryesisht është ne fushen e prodhimit e te tregetimit te bojrave, administrator është Kujtim Beqja.

Ortaku Dhimitri Luleme, ka kerkuar qe te largohet nga pjesemarrja ne shoqeri dhe i ka ofruar pjesen e tij prej 20% te kuotave, ortakeve te tjere, te cilët janë dakord ti blejne ato ne menyre te barabarte ndërmjet tyre. Per kete është hartuar edhe kontrata perkatese e shitblerjes se kuotave dhe janë kryer likuidimet perkatese.

Kjo gjendje ben te domosdoshme ndryshimet ne ortaket pjesemarres dhe ne kuotat e tyre te kapitalit.

Keto ndryshime nuk bien ndesh dhe janë ne perputhje me statutin e shoqerise dhe me ligjin nr.7638 date 19.11.1992.

PER KETE ARESYE

Asambleja e Ortakeve e shoqerise "DORIAN" shpk, duke u mbeshtetur ne nenin 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992, dhe ne statutin e shoqerise,

***V E N D O S I***

1. Te pranohet largimi i ortakut Dhimitri Luleme nga pjesemarrja ne shoqerine DORIAN shpk.
2. Te miratohet shitblerja e 20% te kuotave nga ortaku Dhimitri Luleme qe largohet tek kater ortaket qe mbeten, Kujtim Beqja, Christos

Spiliotopoulos, Milto Hodo dhe Artan Beqja, ne menyre te barabarte nga 5% secili, duke u bere keshtu secili prej tyre me nga 25% te kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri.

3. Te dergohet nje kopje e ketij vendimi ne Gjykaten e Rrethit Tirane per t'u bere shenimet perkatese ne Skeden e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Ky vendim hyn ne fuqi me nenshkrimin e tij nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

KUJTIM BEQJA

CHRISTOS SPILIOTOPOULOS

MILTO HODO

ARTAN BEQJA

DHIMITRI LULEME

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NOTERE SHPRESA SKRAME
NR.REP.575 NR.KOL.94

***VERTETIM***

Sot, me daten 3.6.2004 ( dymijekater) para meje noteres Shpresa SKRAME, u paraqiten personalisht personat e poshteshenuar:

***Kujtim BEQJA***, i biri i Iljazit, dtl. 7.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane, identiteti sipas pasaportes nr.Z0893612;

***Christos SPILIOTOPOULOS,*** i biri i Nikolaos, dtl.09.05.1940, lindur dhe banues ne Agioi Anargyroi, Attikis, Greqi, identiteti sipas pasaportës nr.767761.

***Dhimitri LULEME***, i biri i Shomos, dtl. 1.07.1964, lindur ne Gjirokaster, banues ne Kavaje, identiteti sipas pasaportës nr.0252364;

***Milto HODAJ***, i biri i Avniut, dtl. 28.12.1962, lindur ne Mallakaster, banues ne Durrës, identiteti sipas pasaportës nr.Z0072358.